



Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raport i Vlerësimit Institucional të
Universitetit të Elbasanit
(Universiteti Aleksandër Xhuvani)**

Dhjetor 2016

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi.....	1
Konteksti i këtij vlerësimi	2
Raport i përmbledhur	3
Përmbledhje e gjetjeve.....	5
Raport i detajuar	7
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	7
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	12
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	17
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	22
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	26

Rreth këtij Vlerësimi

Qëllimi i përgjithshëm i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë në çfarë shkalle IAL-ja përmbush Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë, që kanë hyrë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi i jashtëm institucional është procesi i vlerësimit me ekspertë të jashtëm, ku çdo grup ekspertësh përbëhet nga ekspertë të Mbretërisë së Bashkuar të caktuar nga QAA-ja, dhe nga ekspertë shqiptarë të caktuar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL). Grupi i vlerësimit drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përfundimtare do të shërbejnë jo vetëm për akreditimin institucional, bazuar në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-ja, por edhe për të informuar IAL-të, qeverinë shqiptare, publikun dhe studentët se si IAL-ja i përmbush standardet. Ky raport, i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet për përmirësime (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së shërbimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxënit të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave më të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve të ndërmarra dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë shkalle IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjyimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur kryhet përmes një skeme me katër shkallë:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur plotësisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja i ka ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mbështetje të specializuar, duke u siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Dr. Terence Clifford-Amos	Kryetar	Nënshkrimi
Znj. Mandy Hobart	Anëtare	Nënshkrimi
Prof. Mark Hunt	Anëtar	Nënshkrimi
Dr. Janthia Taylor	Anëtare	Nënshkrimi
Prof. Juliana Latifi	Anëtare	Nënshkrimi
Dr. Gergj Thomai	Anëtar	Nënshkrimi

Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti i Elbasanit (Universiteti "Aleksandër Xhuvani") u themelua në vitin 1991 mbi bazën e Normales së Elbasanit, që u çel në vitin 1909. Ky institucion përbëhej nga disa departamente të formimit të mësuesve (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Matematikë dhe Fizikë, Histori dhe Gjeografi, Kimi dhe Biologji), si dhe departamentet e Inxhinierisë dhe Ekonomikut, si degë që vareshin nga Universiteti i Tiranës. Më 12 nëntor të vitit 1991, ky institucion mori emrin Universiteti "Aleksandër Xhuvani", sipas filologut dhe mësuesit shqiptar.

Universiteti është mjaft i njohur në Shqipëri, veçanërisht në formimin e mësuesve para ushtrimit të detyrës, dhe për përgatitjen e specialistëve dhe studiuesve të rinj në fusha të ndryshme studimi. Aktualisht, ky universitet ka pesë fakultete: Fakultetin e Shkencave Humane, Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Fakultetin e Shkencave të Edukimit, Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike. Që prej krijimit të tij si një universitet me të drejta të plota, ky institucion ka punuar për krijimin e strukturave ndihmëse dhe mbështetëse, ku përfshihen laboratorët dhe qendrat e kërkimit shkencor, për të përmirësuar procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Universiteti ofron një larmi programesh studimi në Bachelor dhe Master: 38 Programe Bachelor, 29 Programe Master Profesional dhe 17 Programe Master i Shkencave, si dhe vetëm një program doktore në Albanologji. Aktualisht, ofrohen 15 programe studimi Bachelor me kohë të pjeshme.

Universiteti bashkëpunon gjerësisht dhe në mënyra të ndryshme me institucione si Ambasadat e Shteteve të Bashkuara, Gjermanisë, Francës dhe Italisë në Tiranë, si dhe me Departamentin e Punëve të Jashtme, Trupat e Paqes dhe Bashkinë e Elbasanit. Universiteti ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Drejtoritë Arsimore Rajonale në mbarë vendin, me Qendrën Spitalore "Xhaferr Kongoli", me spitalin psikiatrik Dr. Sadik Dinci, me institucione private, si me kompaninë KURUM, dhe me disa banka të nivelit të dytë. Ndërkombëtarizimi është një veprimtari e nivelit të lartë të axhendës. Universiteti ka nënshkruar disa marrëveshje, si me Universitetin Teknik të Sofjes dhe Universitetin e Barit në Itali.

Raport i përmbledhur

Universiteti Aleksandër Xhuvani është një institucion publik, godinat e të cilit ndodhen në qendrën e qytetit të Elbasanit, si dhe në afërsi të saj. Universiteti ofron programe studimi të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në gjuhën shqipe. Universiteti ka pesë fakultete: Fakultetin e Shkencave Humane, Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Fakultetin e Shkencave të Edukimit, Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike.

Raporti i Vetëvlerësimit u autorizua nga Rektori i Universitetit dhe u përgatit nga Grupi i Vetëvlerësimit të universitetit, i cili udhëzohet nga APAAL-i gjatë këtij procesi. Ky grup përbëhej nga menaxherë të nivelit të lartë, anëtarë të stafit akademik dhe personelit mbështetës, si dhe nga një përfaqësues i studentëve.

Vizita u krye përgjatë dy ditëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga katër ekspertë të arsimit të lartë me përvojë nga Mbretëria e Bashkuar dhe nga dy anëtarë me përvojë në arsimin e lartë nga personeli i institucioneve shqiptare. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri i Vlerësimit dhe një mbajtës shënimesh, të caktuar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë në Shqipëri (APAAL). Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe dosja me dokumentet mbështetëse, tetë javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit, të plotësuar më pas nga dokumentet e kërkuara shtesë. Janë shqyrtuar 86 dokumente gjithsej. Dokumentacioni e ndihmoi Grupin e Vlerësimit të Jashtëm të njihet me strukturën, politikën, procedurat e menaxhimit dhe me natyrën e veprimtarive të mësimdhënies dhe kërkimit të ndërmarrë në universitet. Dokumentet përfshinin Statutin e Universitetit, rregulloret akademike, raportet vjetore, procedurat e pranimit dhe orientimit, listën e marrëveshjeve të jashtme dhe memorandumeve, shembujt e informacioneve rreth programit dhe dokumentacione të mbledhjeve vendimmarrëse.

Gjatë procesit të vlerësimit, grupi u takua me Rektorin, drejtuesit e lartë, studentët, pedagogët, personelin mbështetës dhe administrativ, si dhe me partnerët e jashtëm dhe punëdhënësit. Intervistat dhe diskutimet shërbyen për qartësimin e procedurave, përgjegjësi individuale dhe kolektive, dhe të shumë pikëpamjeve në kuadrin e misionit të universitetit. Gjatë të gjitha takimeve u mbajtën shënime. Si pjesë e vizitës në kampusin kryesor, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekën qendrore, bibliotekat e dy fakulteteve, ambientet e mësimdhënies, laboratorët dhe zyrat, si dhe patën mundësi të shihnin një demonstrim të sistemit online dhe sistemit elektronik të informacionit të universitetit.

Universiteti i përmbush kryesisht standardet për organizimin dhe menaxhimin e tij. Angazhimi i fakultetit në jetën ekonomike të Elbasanit dhe të rajonit, për përgatitjen e kurrikulave akademike në bashkëpunim me industrinë kyçe të punësimit, si në shëndetësi, arsim dhe financë, vërteton angazhimin e universitetit në shkallë kombëtare dhe në sipërmarrjen proaktive, gjë që është karakteristike e praktikës së mirë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e identifikoi si dobësi mosqetjen e provave, që tregojnë se universiteti përdor një qasje sistematike për kërkimin e tregut, mbi të cilën mbështet proceset e vendimmarrjes dhe vendimet lidhur me aspektin akademik dhe projektet kërkimore. Në mënyrë të ngjashme, mungesa e statistikave të plota për vendet që ofron tregu për këto profesione, u identifikua si dobësi e kësaj fushe, pasi të dhëna të tilla do të mbështesnin zhvillimet akademike, dhe do ta nguliste procesin e marrjes së informacioneve mbi tregun si praktikë gjatë përgatitjes së programeve të reja akademike të studimit. Gjithashtu, universiteti duhet të përgatisë planet e veprimit të lidhura me raportet kyçe, duke përfshirë raportet e institucioneve më të rëndësishme, që mund të përmirësojnë vlerësimin e progresit dhe zhvillimit të ardhshëm. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që këto çështje të trajtohen në të ardhmen e afërt.

Përgjegjësitë për menaxhimin e burimeve i përmbushin kryesisht standardet e cilësisë. Politika e punësimit me kohë të pjesshme e ish-studentëve dhe doktorantëve aktualë, e cila i vjen në ndihmë punësueshmërisë së studentëve dhe përgatitjes së kurrikulës, në përputhje me Procesin e Bolonjës, si dhe që mbështet ofrimin e një bashkëpunimi dhe angazhimi më të madh të stafit në projektet ndërkombëtare dhe bashkëpunimet në shkallë më të gjerë, konsiderohen të jenë hartuar relativisht mirë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vuri në dukje se universiteti duhet të zyrtarizojë përdorimin e vlerësimeve vjetore të stafit për të mbështetur programin e zhvillimit institucional për fuqizimin e pedagogjisë. U identifikuan dobësi lidhur me kriteret e sigurisë dhe hapësirës, dhe u rekomandua që universiteti të vazhdojë me hapat që garantojnë përmbushjen e kriteve të sigurisë nga zjarri dhe hapësirës minimale në të gjitha fakultetet.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi disa prej veprimeve të ndërmarra, që lidhen me procesin e kontroleve në nivel departamenti, fakulteti dhe institucioni, dhe që shërbejnë për garantimin e saktësisë dhe qartësisë së informacionit që u jepet studentëve. Rritja profesionale e stafit, e mbështetur në vlerësimet vjetore të tij, përkrah përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit dhe përmirësimi i vazhdueshëm i bazës së të dhënave të studentëve do t'i japë mundësinë stafit të monitorojë performancën e studentëve në nivel grupi dhe programi.

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht. Praktikën e mira u vunë re në sistemin EMS të universitetit, i cili i jep studentëve dhe stafit një pikë të vetme aksesit të të dhënave të studentit (përfshirë rezultatet e provimeve), oraret, komunikimet dhe burimet e të nxënësve. Gjithashtu, ky sistem i pajis studentët me informacione rreth mundësive të disponueshme për t'u angazhuar në praktika profesionale dhe stazhe, të cilat i ndihmojnë studentët për punësim në të ardhmen, dhe garantojnë dhënien e kontributit nga ana e universitetit në ekonominë vendore.

Në kontekstin e informacionit të përftuar nga industritë partnere, u konstatua se përditësimi i vazhdueshëm i programeve akademike, i cili çon rrjedhimisht në përmirësimin e programeve dhe mundësive të punësimit për të diplomuarit, është realizuar mjaft mirë. Dobësia e vetme e kësaj fushe ka të bëjë sërish me statistikën rreth punësimit dhe vendeve që ofron tregu për këto profesione. Për sa i përket fushës së kurrikulave, u vlerësua se mungesa e tyre mund të dëmtojë marrjen e informacionit mbi tregun, rishikimin e kurrikulës dhe planifikimin e të ardhmes.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandoi që universiteti t'i përdorë më mirë rekomandimet e ofruara në raportet vjetore, duke garantuar një monitorim sistematik dhe transparent nëpërmjet komisioneve në nivel departamenti, fakulteti ose institucioni.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur pjesërisht. U vu re se organizimi dhe dokumentimi lidhur për hartimin e programeve për secilin program studimi është realizuar mirë nga universiteti, si dhe se universiteti zotëronte kapacitetin e mjaftueshëm për të mundësuar realizimin me sukses të formimit profesional dhe praktik të studentëve. Kjo përfshin punën laboratorike, modulet laboratorike, veprimtaritë praktike të fushës, praktikën profesionale të udhëhequra brenda ambienteve të universitetit, si dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera vendore, qoftë publike ose private.

Aktualisht, universiteti nuk ka asnjë strukturë mbështetëse për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e identifikoi këtë si një dobësi që duhet trajtuar. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerësoi faktin që universiteti po punon për rritjen e cilësisë së tij, duke bërë përmirësime të vazhdueshme në nivel departamenti, fakulteti ose institucioni. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi përkrahjen që ka universiteti për pjesëmarrjen dhe ndjekjen e rregullt të konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në fushën e mbështetjes së studentëve, standardet janë përmbushur kryesisht. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se programi i studimit Bachelor në Gjuhën Shqipe dhe Rome në Fakultetin e Shkencave Humane, i cili lehtëson integrimin e komunitetit rom në arsimin e lartë në Shqipëri, ishte një karakteristikë e praktikës së mirë. Universiteti organizon praktikën efikase profesionale, veçanërisht në Shkencat Mjekësore Teknike dhe Shkencat e Edukimit. Praktikën profesionale në këto dy fakultete janë të organizuara mirë dhe kanë arritur një zhvillim të qëndrueshëm. Si pika të dobëta të ofrimit të shërbimit identifikohen: mungesa e një strukture të veçantë për pritjen, dhënien e informacionit dhe pranimin e studentëve të rinj, si dhe mungesa e një strukture të ngjashme për studentët ekzistues që vazhdojnë studimet. Dy fusha të tjera që kanë nevojë për zhvillim përfshijnë një strukturë dhe një rregullore për tutorimin dhe mentorimin individual të studentëve, si dhe ngritjen e një Qendre funksionale për Alumnit. Kjo e fundit u identifikua si dobësi dhe lidhet gjithashtu me pikat e tjera të parashtruara në Fushat e Vlerësimit 1 dhe 3 të këtij raporti, në lidhje me punësimin e duhur dhe bazën e të dhënave të statistikave për vendet që ofron tregu për këto profesione, si dhe me nevojën për një bazë të plotë dhe të përshtatshme të dhënash për studentët aktualë.

Studentët kanë të drejtë të kenë një Këshill Studentor efikas dhe përfaqësues. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideroi këtë situatë si dobësi. Nga intervistat, doli që, pjesa më e madhe e studentëve ishin të painformuar rreth ekzistencës së Këshillit Studentor. Sugjerohet ngritja e një Këshilli Studentor në çdo fakultet dhe ofrimi i mbështetjes së plotë nga ana e universitetit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi pasurimin e vazhdueshëm të bibliotekës, kërkesat e bibliotekës qendrore për financim

lidhur me dixhitalizimin, si dhe përpjekjet e universitetit për të mbështetur pjesëmarrjen e studentëve në veprimtari kulturore.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktikat e mira

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- angazhimi i fakultetit në jetën ekonomike të Elbasanit dhe rajonit, për përgatitjen e kurrikulave akademike në bashkëpunim me industrinë kyçe të punësimit, si në shëndetësi, arsim dhe financë (pika 1.14)
- sistemi gjithëpërfshirës EMS i universitetit, i cili i ofron studentëve dhe stafit një pikë të vetme aksesit tek informacionet kryesore të studimit (pika 3.12)
- mundësitë për angazhimin e studentëve në praktika profesionale dhe stazhe, të cilat i ndihmojnë ata për punësim në të ardhmen, dhe garanton dhënien e kontributit nga ana e universitetit në ekonominë vendore. (pika 3.13)
- programi i studimit Bachelor në Gjuhë Shqipe dhe Rome në Fakultetin e Shkencave Humane (2012), i cili lehtëson integrimin e komunitetit rom në arsimin e lartë në Shqipëri (pika 5.10).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- në raportet kryesore të universitetit mungojnë planet e veprimit që janë të matshme, të realizueshme dhe me afate kohore (pika 1.7)
- mungesa e raporteve të informacioneve mbi tregun në përgatitjen e portofolit akademik dhe të kërkimit për të gjithë universitetin (pika 1.11)
- dokumente të pakta të disponueshme për monitorimin dhe ndjekjen e punësueshmërisë së të diplomuarve në nivel fakulteti dhe universiteti (pika 1.12)
- universiteti nuk i përmbush normat e hapësirave të përdorshme për studentët (minimumi 3.8 m² dhe maksimumi 8.0 m²) dhe kriteret për shkallët dhe daljet duhet të përmirësohen në përputhje me udhëzimet statutorë (pika 2.11)
- të dhëna të paplota për punësimin e të diplomuarve, që mund të pengojë marrjen e informacioneve mbi tregun, rishikimin e kurrikulës dhe planifikimin në të ardhmen (pika 3.20)
- universiteti nuk ka struktura mbështetëse për nxitjen e përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies (pika 4.6)
- universiteti nuk ka një sistem të dhënash për ruajtjen e të gjitha të dhënave të kontaktit të studentëve (pika 5.6)
- universiteti nuk ka një Këshill Studentor tërësisht efikas, përfaqësues dhe të promovuar mirë (pika 5.15)
- universiteti nuk ka asnjë bazë të dhënash për alumnit, dhe një Qendër Alumni (pika 5.22).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- përgatitjen e planeve të veprimit të lidhura me raportet kryesore të universitetit të cilat mund të rrisin vlerësimin e progresit dhe zhvillimet e ardhshme (pika 1.7)
- ngulitjen e procesit të marrjes së informacionit nga tregu si praktikë gjatë përgatitjes së programeve të reja akademike të studimit ose ndërmarrjes së projekteve të kërkimit (pika 1.11)
- përgatitjen e një strategjie dhe plani operacional sistematik për punësueshmërinë dhe monitorimin e analizës së të dhënave në nivel fakulteti dhe universiteti për të përkrahur zhvillimin akademik (pika 1.12)
- të vijohen hapat që garantojnë përmbushjen e kriterëve të sigurisë nga zjarri dhe hapësirës minimale në të gjitha fakultetet (pika 2.11)

- universiteti duhet të punojë për të ndjekur një qasje më sistematike për mbledhjen e plotë ose pothuajse të plotë rreth punësimit të të diplomuarve, në mënyrë që t'i kuptojë më mirë prirjet e tregut dhe t'i pasqyrojë ato në ndryshimet e kurrikulës (pika 3.20)
- universiteti duhet të krijojë një strukturë formale mbështetëse për promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies (pika 4.6)
- universiteti duhet të krijojë dhe ruajë një sistem gjithëpërfshirës të dhënash, me të gjitha të dhënat e kontaktit të të gjithë studentëve (pika 5.6)
- universiteti duhet të krijojë një Këshill Studentor tërësisht efikas, përfaqësues dhe të promovuar mirë (pika 5.1)
- universiteti duhet të ngrejë një strukturë për ruajtjen e të dhënave statistikore mbi punësimin e të diplomuarve të tij dhe duhet të krijojë Qendrën e Alumnit (pika 5.22).

Pohimi i veprimeve që po ndërmerren

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- universiteti nxit pjesëmarrjen dhe angazhimin në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare (pika 4.9).

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht.
- 2 Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht.
- 3 Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht.
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur kryesisht.

Gjykim i përmbledhur

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon Këshillit të Akreditimit se në Universitetin e Elbasanit, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht.

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1 Statuti i Universitetit **[Dokumenti: 1.2 Statuti i UE-së]** parashtron misionin dhe parimet organizative për organizimin e brendshëm të universitetit. Krahas kësaj, statuti përcakton përgjegjësitë kryesore të roleve të Rektorit, Zv. Rektorit dhe Kancelarit. Universiteti ka një strukturë efikase për menaxhimin e përgjegjësive, ku Rektori mban përgjegjësi absolute për cilësinë dhe standardet. Kancelari është përgjegjës për menaxhimin ditor financiar dhe administrativ të universitetit, në përputhje me kriteret ligjore dhe statutoe. Universiteti drejtohet sipas ligjeve të shtetit **[Dokumenti 1.1 - Rregulloret e Institucionit; Manual Shtojca 1]**, mbi të cilat bazohet struktura organizative e universitetit, duke përfshirë drejtuesit e lartë, komisionet kryesore, si dhe strukturat e fakultetit dhe ato administrative. **[Dokumenti: 1.17 Diagrami 1 & 1.18 Diagrami 2- Paketa e dytë, Mbledhja 9] [Kapitulli III, Standardi I.1]**
- 1.2 Universiteti ka disa organe kyçe vendimmarrëse. Një ndër to është Këshilli i Etikës, një organ i zgjedhur, përbërja e të cilit përcaktohet nga Senati. Synimi i tij kryesor është të diskutojë rreth çështjeve etike në shkallë universiteti dhe t'i bëjë propozime Rektorit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vërejtë se termat e referencës ishin disi të pamjaftueshme dhe do të kishte qenë më mirë nëse ato do të ishin më të qarta për sa i përket kriterëve dhe fushave të anëtarësimit, të cilat ishin paksa të kufizuara. **[Dok.: 1.8 Kodi i Etikës, rregullat dhe rregulloret e tij]** Organi kryesor vendimmarrës në nivel fakulteti është Këshilli i Fakultetit, **[Dok.: Ligji Nr. 80, 2015]**, i cili përbëhet nga përfaqësues të zgjedhur të stafit akademik. Qëllimi i tij kryesor është të përcaktojë se si do të përdoren burimet njerëzore dhe fizike. Këshilli i Profesorëve është përgjegjës për doktoraturat dhe organizimin e trajnimeve formuese për stafin. **[Dok: 24 - Këshilli i Profesorëve- Paketa e dytë]** Universiteti ka pesë fakultete dhe secili prej tyre harton rregulloret e veta, në përputhje me statutin dhe rregulloren e Universitetit. **[Dok: 1.2, Statuti i UE-së, Neni 7] [Dok.: Mbledhjet 3, 4 dhe 5]** U konstatua se strukturat e larta drejtuese në nivel universiteti dhe fakulteti, duke përfshirë këtu edhe rolet dhe përgjegjësitë e drejtuesve të lartë dhe organeve vendimmarrëse, ishte paraqitur shumë qartë. **[Kapitulli III, Standardi I.2]**
- 1.3 Menaxhimi i standardeve dhe cilësisë akademike i përket fakulteteve, ku secila prej të tyre ka rregulloret e veta. **[Dok.: 1.1 Rregulloret e UE-së, 1.2 Statuti i UE-së]** Dekani i Fakultetit është autoriteti drejtues më i lartë dhe përfaqësuesi ligjor përgjegjës për drejtimin e shërbimeve që ofron fakulteti. Dekani zgjidhet nga stafi akademik dhe studentët, dhe miratohet nga Rektori, në përputhje me statutet ligjore të arsimit. **[Dok.: 1.2: Statuti 18 i UE-së; Manuali Shtojca 1]** Si pjesë e strukturës së mbledhjeve vendimmarrëse të universitetit, Dekani punon ngushtësisht me Këshillin e Fakultetit dhe Bordin e Administrimit për shqyrtimin e strategjive dhe zhvillimeve në proces e sipër. **[Dok.: 1.9 Rregullat & Rregulloret e Fakultetit të Ekonomikut]** Për sa i përket studimeve të doktoraturës, Këshilli i Profesorëve vepron në mënyrë të tillë që të sigurojë vlerësime dhe vendimmarrje efikase të kolegëve lidhur me doktoraturën në Albanologji, që është edhe doktoratura e vetme që ofrohet aktualisht nga universiteti. **[Dok.: 1.10 Vendimi i Senatit për Këshillin e Profesorëve] [Kapitulli III Standardi I.2] [ESG 1.1 Politika për Sigurimin e Cilësisë]**
- 1.4 Dokumentet për komisionet kryesore të universitetit, duke përfshirë Senatin, Bordin e Administrimit dhe Këshillat e Fakultetit u shpërndahen anëtarëve përpara mbledhjeve me qëllim përmirësimin e procesit të vendimmarrjes dhe debatit. Komisionet mbledhen çdo muaj dhe monitorojnë rezultatet e mbledhjes. **[Dok.: 1.11 - Rregullorja e Senatit]** Parimi i diskutimit të hapur përcaktohet në Parimet Organizative të Statutit. **[Dok.: 1.2 Statuti, Neni 3.3]** Gjatë mbledhjeve me stafin dhe me studentët e të gjithë cikleve, u vërtetua se universiteti vepronte në mënyrë transparente dhe të hapur, dhe reagonte ndaj feedback-ut që merrete. **[Dok.: - Mbledhjet 4 dhe 5] [Kapitulli III Standardi I.3 & Kapitulli III Standardi II.3]**
- 1.5 Në vitin 2014, universiteti krijoi Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) për të mbështetur proceset e akreditimit dhe sigurimin e cilësisë në universitet. Çdo

fakultet ka një përfaqësues të emëruar, i cili ndihmon në ndarjen dhe shkëmbimin e praktikave, si dhe merr pjesë në seminare dhe mbledhje. Njësia nuk është angazhuar ende në asnjë formë të konsultimeve të jashtme. **[Dok.: RVV fq. 12]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në vlerësimin se NjSBC-ja do të përfitonte më shumë po të kishin ekspertizë dhe përvojë të huaj nga sisteme të tjera të sigurimit të cilësisë, për të ndihmuar në përmirësimin e mëtejshëm të qasjes së universitetit për mbështetjen e stafit dhe përmirësimin e programeve të studimit. **[Kapitulli III, Standardi I.4]**

- 1.6 Universiteti ka përgatitur një Strategji Zhvillimi për vitin akademik 2015-2016, **[Dok.: 1.14 - Strategjia e Zhvillimit 3.2]** në të cilin përvijohen objektivat. Këto të fundit jo vetëm që janë të përshtatshme, por përcaktojnë edhe mjetet për të arritur rezultatet e pritshme. Megjithatë, objektivat mund të përforcohen më tej duke përfshirë edhe treguesit kyç të performancës, që ndihmojnë në matjen e rezultateve. **[Dok.: - Mbledhja 2 & E1.14]** **[Kapitulli III Standardi I.5]**
- 1.7 Rektorati i paraqet senatit raportin vjetor, ku përfshihet analiza e treguesve të procesit të kërkimit dhe të mësimdhënies. Raporti vjetor mbështetet në raportet e departamenteve dhe fakulteteve. **[Dok.: 1.15 - Raporti Vjetor i UE-së]** Raporti i vihet në dispozicion këshillave dhe bordeve të universitetit dhe i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në përputhje me kërkesat e qeverisë, si dhe publikohet në faqen e internetit për personelin dhe studentët. Ky raport ofron një vështrim të përgjithshëm të zhvillimeve dhe veprimtarive të jashtme, të shoqëruara me fushat për zhvillim, mbështetur në raportet e fakultetit dhe analizën e të dhënave. **[Dok.: 1.16 Raporti Vjetor - Raporti i Fakultetit të Shkencave Humane; 1.15 Raporti Vjetor i UE-së; Mbledhja 3]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm këshillon se rezultatet e raportit mund të ndiqen më me efikasitet, nëse do të përfshiheshin në një plan veprimi të matshëm, të realizueshëm dhe me afate kohore. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e identifikoi mungesën e këtyre aspekteve si **dobësi**. **[Dok.: 1.16 - Raport vjetor për veprimtaritë akademike dhe shkencore të Fakultetit të Shkencave Humane]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që të gjitha raportet kryesore të universitetit të përfshijnë një plan veprimi, ku të përcaktohet se si do të matet performanca (e brendshme dhe e jashtme), për të garantuar përputhshmërinë e veprimtarisë së universitetit me prioritetet kyçe. **[Kapitulli III Standardi I.6] [ESG 1.8 Informacioni publik]**
- 1.8 Universiteti ushtron autonominë dhe lirinë akademike, që mbështeten nga misioni dhe qëllimi i tij. Midis të drejtave të tij renditen: hartimi i programeve të studimit dhe ndërmarrja e projekteve kërkimore, përzgjedhja dhe emërimi i stafit akademik dhe personelit administrativ, përcaktimi i kriterëve për pranimet, përcaktimet e kushteve për nënshkrimin e marrëveshjeve me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe e drejta për të administruar fondet publike. **[Kapitulli III Standardi I.4 & Kapitulli III Standardi II.1]**
- 1.9 Universiteti ofron programe studimi në tre cikle: Bachelor, Master dhe Doktoraturë. Ai ka pesë fakultete: Fakultetin e Shkencave Humane, Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Fakultetin e Shkencave të Edukimit, Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike dhe Fakultetin Ekonomik. Universiteti ndërmerr kërkime shkencore themelore dhe të zbatuara. **[Dok.: 1.17 Struktura organizative e UE-së]** Fakultetet funksionojnë si njësitë kryesore të universitetit. Secili fakultet ka të paktën tre njësi bazë (departamente dhe qendra kërkimi) prej të cilave dy janë departamente. Departamentet përbëhen nga të paktën 7 anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë, në mënyrë që të përmbushen standardet shtetërore; **[Dok.: 1.18- Struktura e stafit akademik të UE-së] [Kapitulli III Standardi II.1]**
- 1.10 Universiteti ka marrë miratimin e Ministrisë për ofrimin e programit të Doktoraturës në Albanologji. Universiteti ka bërë kërkesë në Ministri për dy programe të tjera doktore, megjithatë, deri tani, ato nuk janë miratuar ende nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. **[Dok.: - Mbledhje 3] [Kapitulli III Standardi II.1]**
- 1.11 Universiteti angazhohet në veprimtari shkencore, sociale dhe ekonomike duke marrë pjesë nëpër konferenca dhe simpoziume kombëtare dhe ndërkombëtare. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk arriti të shihte apo të dëgjonte diçka që të vërtetonte faktin se universiteti po ndiqte një qasje sistematike për kërkimin e tregut, mbi të cilën mbështet proceset vendimmarrëse, si dhe vendimet lidhur me aspektin akademik dhe

projektet kërkimore. **[Dok: Nuk është dorëzuar asnjë dokument ose provë në RVV ose dokumentet bazë, Mbledhja 2 me Rektorin-Pyetja 5-Nuk u dha asnjë provë, Mbledhja 3-Pyetja 15-Nuk u dha asnjë provë me vlerë]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e identifikoi këtë si **dobësi** dhe **rekomandoi** që universiteti ta ngulisë procesin e marrjes së informacionit mbi tregun si praktikë gjatë përgatitjes së programeve të reja akademike të studimit, ose ndërmarrjes të projekteve madhore kërkimore. **[Kapitulli III, Standardi III.1]**

1.12 Universiteti deklaroi se zbatonte një proces për monitorimin e punësimit të të diplomuarve përmes një baze të dhënash, por në Raportin e Vetëvlerësimit dhe në mbledhje, ai raportoi se ky proces nuk zbatohet ende sistematikisht në të gjithë universitetin. **[Dok: RVV fq. 16, Dok: Mbledhja 7, 8 dhe 9]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i konsideroi provat e kufizuara për ndjekjen dhe monitorimin e punësimit të të diplomuarve si **dobësi** dhe **rekomandon** që universiteti të zhvillojë një qasje sistematike për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të punësueshmërisë, për t'i përdorur në përgatitjen e portofoleve të ardhshme akademike. **[Kapitulli III, Standardi III.1]**

1.13 Universiteti bashkëpunon me një numër të madh partnerësh për shkëmbimin e studentëve dhe personelit. **[Dok.: 1.13 - Lista e projekteve ndërkombëtare, ku UE-ja është partnere]** Kjo gjë mbështetet nga dy departamente: Drejtoria e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë. Gjithashtu, universiteti është një qendër e rëndësishme profesionale, prandaj disa programe janë hartuar nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike dhe ai i Shkencave të Edukimit për të mbështetur nevojat vendore. Janë lidhur një sërë marrëveshesh bashkëpunimi në shkallë rajonale, si p.sh. me Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë dhe me Drejtoritë Arsimore. **[Dok.: 1.20 - Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit] [Mbledhjet 3, 6, 7 dhe 8]** Universiteti po përpiqet të lidhë partneritete të reja me institucione të tjera të arsimit të lartë, në shkallë rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare, për të shtuar mundësitë e kërkimit dhe për të mbështetur shkëmbimin e studentëve. Lidhja e partneriteteve është tejet e efektshme, pasi i ofron më shumë mundësi për mësimnxënie studentëve dhe mbështet përgatitjen e programeve. **[Dok.: 1.14 Strategjia e zhvillimit të UE-së; 1.20 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit]** Universiteti bashkëpunon edhe me disa institucione shqiptare, duke përfshirë Marrëdhëniet me Jashtë, Trupat e Paqes dhe Ambasadat në Tiranë, si dhe merr pjesë në disa veprimtari sportive dhe kulturore. **[Dok.: Mbledhjet 3 dhe 7] [Kapitulli III Standardi III.2]**

1.14 Strategjia e Zhvillimit përfshin deklarata strategjike bashkëpunimi me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare. Drejtoria e Marrëdhënieve Ndërkombëtare është përgjegjëse për administrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit. **[Dok.: 1.14 dhe 1.20; 1.19; Mbledhjet 3 dhe 5]** Puna e universitetit me punëdhënësit vendorë, kryesisht me zyrat e taksave, bankat vendore, shërbimin doganor, spitalet dhe shkollat e mesme, është e vlefshme veçanërisht lidhur me veprimtaritë formuese që iu ofrohen studentëve në kushte reale. Punëdhënësit vendorë vlerësojnë përpjekjet e universitetit për krijimin e lidhjeve me strukturat vendore dhe cilësinë e studentëve që kishin ardhur të punonin me ta. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e vlerëson angazhimin e fakultetit në jetën ekonomike të Elbasanit dhe të rajonit për përgatitjen e kurrikulave akademike në bashkëpunim me industrinë kyçe të punësimit si karakteristikë të **praktikës së mirë.** **[Kapitulli III, Standardi III.3]**

1.15 Universiteti ndjek një qasje ndërkombëtare në punën e tij. Ai jep leje sabatike për stafin akademik, si dhe financon projektet afatshkurtra. Mobiliteti i studentëve kryhet si brenda, ashtu edhe jashtë universitetit, ndonëse nuk ofron asnjë program në gjuhë të huaj. Shpesh, studentëve që regjistrohen për herë të parë u ofrohet një trajtim individual. Studentëve nga trevat shqipfolëse iu ofrohen bursa. Për të mbështetur mobilitetin në kuadrin e programit Erasmus, universiteti zbaton një politikë integrimi për lektorët e ftuar dhe studiuesit e huaj. Stafi angazhohet edhe në konventa dhe konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. **[Dok.: 1.13 - Lista e projekteve ndërkombëtare / 1.20 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit] [Kapitulli III Standard III.4]**

1.16 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e identifikon angazhimin e universitetit në jetën ekonomike të Elbasanit dhe në përgatitjen e kurrikulës akademike në përputhje me mundësitë e punësimit për studentët, si karakteristikë të praktikës së mirë. Midis dobësive të

identifikuara renditen: mospërfshirja e planeve të matshme, të realizueshme dhe me afate kohore të veprimit në raportet kryesore të universitetit **[Kapitulli III Standardi I.6]** prova të pakta të disponueshme për ndjekjen dhe monitorimin e punësimit të të diplomuarve në nivel universiteti, **[Kapitulli III Standard III.1]** dhe mungesa e informacionit rreth tregut, që mbështesin zhvillimin e portofolit akademik të universitetit dhe projektet kërkimore.**[Kapitulli III Standardi III.1]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që universiteti të zhvillojë një qasje sistematike për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të punësueshmërisë, në mbështetje të zhvillimit të programit akademik, ngulitjen e përfshirjes së raporteve të informacioneve mbi tregun si praktikë gjatë përgatitjes së zhvillimeve të ardhshme të portofolit akademik dhe kërkimor, dhe përfshirjen e planeve të qarta të veprimit në raportet kryesore të universitetit, për të përmirësuar vlerësimin dhe zbatimin e rekomandimeve.

Gjetjet

Praktikat e mira

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikave të mira:

- angazhimi i fakultetit në jetën ekonomike të Elbasanit dhe të rajonit për përgatitjen e kurrikulave akademike në bashkëpunim me industrinë kyçe të punësimit, si në shëndetësi, arsim dhe financë (pika 1.14)

Dobësitë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesa e planeve të veprimit që janë të matshme, të realizueshme dhe me afate kohore në raportet kryesore të universitetit (pika 1.7)
- mungesa e raporteve me informacione mbi tregun dhe përdorimi i tyre në përgatitjen e portofolit akademik dhe kërkimor në nivel universiteti (pika 1.11)
- prova të pakta të disponueshme për monitorimin dhe ndjekjen e punësueshmërisë së të diplomuarve në nivel fakulteti dhe universiteti (pika 1.12).

Rekomandimet

Grupi i vlerësimit dha rekomandimet e mëposhtme:

- përgatitja e planeve të veprimit në lidhje me raportet madhore të universitetit, të cilat mund të përmirësojnë vlerësimin e progresit dhe zhvillimet e ardhshme (pika 1.7)
- ngulitja e procesit për marrjen e informacioneve mbi tregun si praktikë gjatë përgatitjes së programeve të reja akademike të studimit ose ndërmarrjes së projekteve kërkimore (pika 1.11)
- përgatitja e një strategjie dhe plani operacional sistematik për punësueshmërinë dhe monitorimin e analizës së të dhënave në nivel fakulteti dhe universiteti, për të mbështetur zhvillimin akademik (pika 1.12).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë lidhur me këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 Universiteti ka një strukturë të qartë, që përcakton përgjegjësitë për menaxhimin e burimeve, për të përmbushur kërkesat e standardeve. **[Dok.: 2.1 Grafiku i Strukturës Organizative; A2 Diagrami i vendimmarrjes; A3 diagrami]** Procedurat e punësimit në universitet drejtohen si nga statutet e jashtme, ashtu dhe nga rregulloret e brendshme për drejtësi dhe përputhshmëri. Departamenti i Burimeve Njerëzore sigurohet që vendet e lira të punës të shfaqen në Buletinin Javor të universitetit dhe në median vendore. Kriteret e punësimit publikohen në faqen e internetit të universitetit për të gjitha palët e interesuara. **[Dok.: 17 Modalitetet e punësimit, 1.3 Modalitetet dhe standardet për punësimin e stafit akademik; 1 Kontrata e punës; 2.5 Tabelë shembull me të gjithë treguesit për punësimin e pedagogëve]** Procedurat mbështesin në mënyrë efikase punësimin e personelit me kualifikimin e duhur, me kohë të plotë dhe të pjesshme, duke përdorur specifikimet dhe kriteret e qarta të përzgjedhjes. **[Dok.: 2.3 Shembull i një njoftimi të një vendi të lirë pune; 2.2 Lista e stafit akademik me kohë të pjesshme]** Gjithashtu, universiteti përkrah punësimin e mjekëve, ish-studentëve dhe doktorantëve aktualë në rolin e pedagogëve me kohë të pjesshme, për të mbështetur mësimdhënien që lidhet me praktikën. **[Dok.: M7 Mbledhje me përfaqësuesit e jashtëm; 2.2 Lista e stafit akademik me kohë të pjesshme 2.7 Shembull i një analize vjetore; Kapitulli III Standardi IV.1; Standardi ESG 1.5 Stafi mësimdhënës]** Punësimi me kohë të pjesshme i ish-studentëve dhe doktorantëve aktualë mbështet punësueshmërinë e studentëve.
- 2.2 Universiteti respekton parimin e ndërkombëtarizimit përmes përpjekjeve për të punësuar anëtarë personeli me përvojë pune nga universitetet jashtë vendit, duke promovuar angazhimin e personelit në projekte ndërkombëtare, si dhe duke lidhur marrëveshje bashkëpunimi. **[Dok.: 1.13 Lista e projekteve ndërkombëtare; 1.16 Raport vjetor i veprimtarive akademike shkencore; 2.5 Treguesit për punësimin e pedagogëve; 3.8 Lista e marrëveshjeve për praktikën profesionale; Kapitulli III Standardi IV.3]** Personeli i fakultetit nxitet të angazhohet në projektet e financuara nga jashtë për të shtuar njohuritë e tyre. Veprimtari të tilla të jashtme i ofrojnë personelit dhe studentëve më shumë mundësi për t'u angazhuar në vizitat dhe shkëmbimet e studentëve/personelit. **[Dok.: Mbledhje me Përgjegjësit e Departamenteve; 2.9 Lista e pedagogëve që kanë qenë jashtë vendit; M4 dhe M5 Takim me studentët, Kapitulli III Standardi IV.3]**
- 2.3 Shtytësit për rritjen ekonomike shërbejnë si faktorë të rëndësishëm për procesin e përgatitjes së kurrikulës. **[M3 Mbledhje me personelin e nivelit të lartë; 1,14 Strategjia e Zhvillimit]** Përafrimi i kurrikulës me Procesin e Bolonjës mbështet bashkëpunimet dhe angazhimin në shkallë më të gjerë në projektet ndërkombëtare, praktikat e shkëmbimit dhe zhvillimin e burimeve. Veprimtari të tilla mbështesin shtimin e njohurive dhe burimeve për universitetin. Këshilli i Profesorëve vlerëson kërkimet e ndërmarra dhe miraton promovimin e personelit duke vlerësuar punën e tyre. **[Dok.: M3 Mbledhje me stafin, 6a Këshilli i Profesorëve]** Deri më sot, 51 pedagogë janë ngritur në detyrë, duke marrë titujt “Profesor i Asociuar” apo “Docent”. **[Dok.: 2.4 Titujt akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Docent” nga Këshilli i Profesorëve; 2.10 Lista e profesorëve të huaj të angazhuar në dhënien e titujve; Kapitulli III Standardi IV.3]** Këshilli i Profesorëve nuk ka të drejtë të japë titullin Profesor, por mund të dërgojë vlerësimet tek universitetet e tjera që e gëzojnë këtë të drejtë, në përputhje me legjislacionin dhe rregullat aktuale. **[Dok.: 2.11 Kërkesë me shkrim e një pedagogu për marrjen e titullit “Profesor” në një universitet tjetër; M3 Mbledhje me personelin e nivelit të lartë]**
- 2.4 Përgatitja e informacionit menaxhohet në mënyrë efikase. Stafi akademik dhe personeli mbështetës angazhohen për përgatitjen e informacioneve për ditët e hapura, duke përfshirë broshurat dhe materialet informuese, në përputhje me politikën e integritetit të universitetit. **[Dok.: 2.6 Raporti për ditët e hapura; M3 Mbledhje me personelin e nivelit të lartë; M6 Mbledhje me tutorët akademikë; M9 Mbledhje me personelin mbështetës, Kapitulli III Standardi IV.2]** Informacioni kontrollohet në nivel programi, departamenti dhe fakulteti, si dhe nga Rektorati përpara se t'i kalojë Qendrës së Këshillimit të Studentëve. **[Dok.: 1.2 Statuti; M3 Personel i nivelit të lartë]** Materialet e përgatitura nga pedagogët kontrollohen nga përgjegjësit e departamenteve dhe u ofrohen studentëve

online.[Dok.: 1.2 Statuti; M.11 Provë e IT-së] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi se kontrollet në nivel departamenti, fakulteti dhe institucioni shërbejnë si mënyrë efikase për të siguruar qartësinë dhe saktësinë e informacionit që i ofrohet studentëve dhe grupeve të tjera të interesit.[Dok.: M4, Takim me studentët, Anketimi i Studentëve; Kapitulli III Standard VII.1; Standardi ESG 1.8 Informacioni publik]

- 2.5 Universiteti ka mekanizma efikase për të komunikuar me stafin dhe studentët e tij, dhe për të mbështetur ndarjen e informacionit rreth veprimtarive dhe projekteve. Personeli dhe studentët informohen rreth aktiviteteve ekstrakurrikulare përmes këndeve të njoftimit dhe emaileve, duke përfshirë edhe linqet për veprimtaritë sportive dhe sociale.[Dok.: M11 Demonstrimi i sistemit të IT-së; M4 dhe M5 Takim me studentët, Kapitulli III Standard IV.2] Informacioni që iu ofrohet anëtarëve të stafit akademik shërben për të nxitur angazhimin në projekte kërkimore dhe bashkëpunimi, duke përfshirë vizitat dhe shkëmbimet e studentëve dhe të personelit.[Dok.: 14 Strategjia e Zhvillimit; 2.7 Analiza sipas departamenteve; M3 Mbledhje me personelin e nivelit të lartë; M5 Mbledhje me stafin akademik; Kapitulli III Standard IV.3]
- 2.6 Universiteti përdor procedura të qarta për monitorimin vjetor të performancës së personelit, mbi rezultatet e të cilave bazohet edhe plani i formimit që hartohet nga universiteti. Stafi akademik plotëson kartelat e vlerësimit, të cilat pasqyrojnë veprimtarinë e mësimdhënies dhe të kërkimit, dhe identifikojnë praktikatat e mira.[Dok.: M3 Mbledhje me personelin e nivelit të lartë; 2.8 Vlerësimi i ngarkesës së punës dhe arritjeve të pedagogëve, M6 Mbledhje me stafin akademik] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi se rritja profesionale e personelit bazohet mbi vlerësimet e tyre vjetore, dhe identifikoi praktikatat e mira që mbështesin përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit. Megjithatë, nuk është e qartë se si kjo gjë mbështet në mënyrë të vazhdueshme zhvillimin e pedagogjisë në të gjithë institucionin.[Dok.: 2.8 Vlerësimi i ngarkesës së punës dhe arritjeve të pedagogëve 2.7 Analizë e ofruar nga departamentet; 1.16 Raport Vjetor - Fakulteti i Shkencave Humane] Zyrtarizimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i vlerësimeve vjetore të personelit duhet të ndihmojë në përgatitjen e një programi për zhvillimin institucional, për të përmirësuar praktikatat pedagogjike, duke përfshirë praktikatat kërkimore nga Fakulteti i Edukimit.[Dok.: M7 Mbledhje me partnerët e jashtëm; 1.15 Raport Vjetor për veprimtaritë akademike dhe shkencore; Kapitulli III Standardi IV.3]
- 2.7 Universiteti përdor procedura transparente për menaxhimin e burimeve financiare. Menaxhim financiar realizohet në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e financave publike, ku llogaritë i kalojnë çdo vit Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për kontroll. [Dok.: 1.5 & Vendimet e Senatit dhe Këshillit Administrativ ose Buxheti për 2016-n; 1.6 Buxheti për 2015-n; 1.1 Rregullorja e Institucionit] Buxhetet janë të centralizuara dhe kërkesat e departamenteve dhe fakulteteve verifikohen nga Rektorati.[Dok.: RVV, fq.21; M3 Mbledhje me personelin e nivelit të lartë; Kapitulli III Standardi VI.1] Buxhetet e propozuara, mbështetur në kërkesat e marra, shqyrtohen dhe miratohen përfundimisht nga Senati dhe Bordi i Administrimit.[Dok.: 2.12 Raporti i buxhetit për vitin 2015 dhe vendimi i Bordit të Administrimit; 1.6 Buxheti për 2015-n; M3 Mbledhje me personelin e nivelit të lartë] Përgjegjësia për menaxhimin dhe administrimin e buxhetit i takon Rektorit dhe Kancelarit, të mbështetur nga Drejtoria Ekonomike.[Dok.: 2.12 Raporti i buxhetit për vitin 2015 dhe vendimi i Bordit të Administrimit; 2.14 Struktura organizative e Drejtorisë Ekonomike] Raportet financiare bëhen publike për grupet e interesit përmes faqes së internetit të universitetit.[Dok.: Linku i faqes së internetit M11 Demonstrim i sistemit të IT-së; Kapitulli III Standardi VI.3]
- 2.8 Buxheti i universitetit i delegohet dhe menaxhohet nga secili fakultet, në mbështetje të përmbushjes së prioriteteve kyçe.[Dok.: M3 Mbledhje me personelin e nivelit të lartë; 1.5 Vendimet e Senatit dhe Bordit të Administrimit për Buxhetin e 2016-s; 2.13 Propozimi i projektbuxhetit nga një fakultet ose departament; a7 Termat e Referencës të Këshillit të Fakultetit; 1.16 Raport Vjetor për veprimtaritë akademike dhe shkencore - Raport Fakulteti; Kapitulli III Standard VI.2] Ndonëse fakultetet mund të përpiqen të gjenerojnë buxhet shtesë, fonde shtesë burojnë kryesisht nga përpjekjet e suksesshme për financimin e jashtëm të projekteve.[Dok.: 2.13 Propozimi i projektbuxhetit; M3 Mbledhje me personelin e nivelit të lartë; 1.13 Lista e projekteve

ndërkombëtare] Universiteti ka marrë pjesë në mënyrë të suksesshme në disa projekte të financuara nga jashtë, të cilat kanë përmirësuar aksesin e personelit dhe studentëve në burime.**[Dok.:1.16 Raporti Vjetor i veprimtarive shkencore; 1.13 Lista e projekteve ndërkombëtare]**

- 2.9 Sistemi i menaxhimit të informacionit drejtohet nga universiteti dhe koordinohet nga Zv. Rektori. Kjo gjë mbështet në mënyrë efikase komunikimin dhe aksesueshmërinë e informacioneve rreth programeve.**[Dok.: 1.1 Rregullorja e Institucionit; 1.2 Statuti i Institucionit; 1.17 Struktura Organizative; M11 Demonstrimi i sistemit të IT-së]** Sistemi elektronik i informacionit (EMS) u ofron studentëve online planet mësimore, informacionet rreth programeve, kalendarin e provimeve dhe materialet e lëndës. **[Dok.: M11 Demonstrimi i sistemit të IT-së; M6 Mbledhje me stafin akademik; M4 dhe 5 Takim me studentët; 2.18 Lista e ambienteve për stafin akademik; Kapitulli III Standard V.2]** Për të garantuar aksesin në të dhënat e programit, po prezantohet një bazë të dhënash dhe sistem i ri menaxhimi, si dhe rregullore që drejtojnë funksionet e universitetit, pjesa më e madhe e të cilave kanë qenë të disponueshme më parë vetëm në format të shtypur.**[Dok.: M11 Demonstrimi i sistemit të IT-së; M3 Mbledhje me personelin e nivelit të lartë]** Duke respektuar kriteret rregullatore, sekretaritë e çdo fakulteti ruajnë një bazë të dhënash për regjistrimin dhe rezultatet e studentëve. **[Dok.: 31 Urdhri për miratimin e programit të transparencës' M11 Demonstrimi i sistemit të IT-së; Kapitulli III Standard V.2]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi se krijimi i bazës online të të dhënave për studentët, duhet t'i ofrojë mundësinë personelit që të monitorojë nga afër ecurinë e studentëve në nivel grupi dhe programi, si dhe të mbështesë menaxhimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe standardeve.
- 2.10 Universiteti ka kampusin dhe godinat e veta, që ndodhen në zona të ndryshme të Elbasanit, dhe është përgjegjës për mirëmbajtjen e të nëntë ambienteve.**[Dok.: 2.16 Lista e pasurive të paluajtshme të institucionit; M2 Mbledhje me Rektoren]** Shtatë zona ofrojnë ambiente për pesë fakultetet, duke përfshirë edhe aksesin për te laboratorët dhe sallat e shkencave kompjuterike.**[Dok.: 2.16 Lista e pasurive të paluajtshme të institucionit; Vizitë në terren; 2.18 Lista e ambienteve për stafin akademik; Kapitulli III Standardi V.1 dhe Standardi VII.3]** Studentët shprehen se janë mjaft të kënaqur me ambientet dhe burimet.**[Dok.: M4 dhe M5; Takim me studentët; Anketim i Studentëve]** Për të përmirësuar strukturat dhe për të mbështetur masat e reja, janë përgatitur planet për ndërtimin e një kampusi të ri në kodrën e Krastës, në periferi të Elbasanit. **[Dok.: 2.20 Projekti i kampusit universitar në Krastë; a9, a10 & a11 Plani kryesor i kampusit universitar në kodrën e Krastës; M1 Mbledhje me Rektoren; Kapitulli III Standardi VII.3]** Në strategjinë e zhvillimit përfshihet edhe një politikë për ruajtjen e trashëgimisë akademike, kulturore dhe shkencore.**[Dok.: 1.14 Strategjia e Zhvillimit; Kapitulli III Standardi VII.4]**
- 2.11 Aktualisht, universiteti nuk e përmbush kriterin e normës minimale statutores të sipërfaqes së përdorshme (minimumi 3.8 m² dhe maksimumi 8.0 m²), pasi në të vërtetë, raporti është 2.1 m²/student. **[RVV fq. 24; M3; Mbledhje me personelin e nivelit të lartë; 2.16 Lista e pasurive të paluajtshme të institucionit]** Për më tepër, standardet për shëndetin dhe sigurinë lidhur me daljet e emergjencës për fakultetet me mbi 200 studentë, nuk janë përmbushur tërësisht.**[RVV fq.24; M3 Mbledhje me personelin e nivelit të lartë]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i identifikoi normat që lidhen me sipërfaqen dhe daljet e emergjencës si **dobësi**. Për të garantuar sigurinë e studentëve dhe personelit, kryhen kontrole çdo vit lidhur me sigurinë ndaj zjarrit, si dhe inspektimet për sigurinë, shëndetin dhe higjienën mjedisore.**[Dok.: a12 Certifikata e mbrojtjes nga zjarri; a13 Certifikata e higjienës & kanalizimeve; a14 Certifikata e Dezinsektimit 2015; a16 Certifikatën e Dezinsektimit 2016]** Universiteti përdor edhe ambientet e jashtme për t'i ofruar studentëve mundësinë e aksesit në burime të specializuara, duke përfshirë dhe ambientet spitalore.**[Dok.: 2.20 Lista e marrëveshjeve institucionale; 1.19 Lista e marrëveshjeve ndër-institucionale për veprimtaritë praktike; 2.16 Lista e pasurive të paluajtshme të institucionit]** Universiteti i ka mjaft të qarta kriteret e parashtruara në udhëzuesin statutor për burimet, dhe ka përgatitur plane për të përmirësuar infrastrukturën dhe për të garantuar përmbushjen e standardeve minimale nga të gjitha godinat.**[Dok.: 1,14 Strategjia e Zhvillimit; 1.6 Buxheti 2015; 1.5 Vendimet e Senatit dhe Bordit të Administrimit për Buxhetin e 2016-s; Kapitulli III Standard V.1]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon

që universiteti të vazhdojë punën për të garantuar përmbushjen e kriterëve lidhur me hapësirën minimale dhe mbrojtjen nga zjarri nga të gjitha fakultetet.

- 2.12 Standardet për burimet, përgjegjësitë për menaxhimin e të cilave përcaktohen qartë në Statutin dhe Rregulloret e Universitetit, janë përmbushur kryesisht. Midis dobësive të identikuara ishin: hapësira e caktuar për student, si dhe daljet dhe shkallët e emergjencës, që nuk i plotësonin kriteret e parashikuara, pavarësisht kontrolleve vjetore të kryera për garantimin e sigurisë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandoi që të trajtohen problemet në lidhje me akomodimin dhe sigurinë ndaj zjarrit. Grupi vërejti një sërë zhvillimesh në proces e sipër, që mbështesin Burimet, duke përfshirë: procesin e kontrolleve në departament; mbështetjen në nivel fakulteti dhe institucioni për qartësinë dhe saktësinë e informacionit që i ofrohet studentëve; krijimin e një baze online për të dhënat e studentëve, që e lejon personelin të monitorojë performancën e studentëve; si dhe përdorimin e vlerësimit të performancës vjetore të personelit për të mbështetur ndarjen e praktikave të mira, si pjesë e programit të rritjes profesionale të personelit.

Gjetjet

Praktikat e mira

Grupi i vlerësimit nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë lidhur me këtë Fushë Vlerësimi.

Dobësitë

Grupi i vlerësimit identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- universiteti nuk i përmbush normat e hapësirave të përdorshme për studentët (minimumi 3.8 m² dhe maksimumi 8.0 m²) (pika 2.11)
- kriteri i universitetit lidhur me shkallët dhe daljet e emergjencës duhet të përmirësohet në përputhje me udhëzimet statutorë (pika 2.11).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- të vijohet me hapat që garantojnë përmbushjen e kriterëve të hapësirës minimale dhe sigurisë ndaj zjarrit në të gjitha fakultetet (pika 2.11).

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë lidhur me këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

- 3.1 Duke pasqyruar origjinën e tij si një institucion për formimin e mësuesve, universiteti i jep përparësi formimit të mësuesve dhe Albanologjisë, e cila është fusha e studimit për doktoraturën e vetme që ai ofron, si dhe përqendrohet gjithnjë e më tepër në disiplinat që lidhen me nevojat e tregut të punës, për shembull, teknologjinë e informacionit, ekonominë, shkencat teknike dhe mjekësore. **[Dok.: RVV, fq.8, fq.27, Dokumenti 1.14, Strategjia e Zhvillimit e UE-së, fq.2, fq.4; Dokumenti 1.2, Statuti, Neni 2.11; Mbledhja 7]**
- 3.2 Universiteti i publikon hollësitë lidhur me programet e tij të studimit në faqen e internetit, në median vendore dhe nëpërmjet ditëve të hapura. **[Dok.: RVV, fq.27]** Faqja e internetit përmban informacione lidhur me të gjitha programet, formularët e aplikimit, hollësitë lidhur me ditët e hapura dhe vizitat në shkollat e mesme vendore. **[Dok.: RVV, fq.27; Prova 2.6, Raport mbi Ditët e Hapura]** Ndonëse universiteti nuk ka një zyrë të posaçme për veprimtarinë në terren, departamentet komunikojnë vazhdimisht me drejtorët e gjimnazeve, të cilët i ofrojnë informacionin e nevojshëm rreth studentëve. **[Dok.: RVV, fq.19-20; Mbledhja 7] [ESG 1.8 Informacioni publik]**
- 3.3 Siç parashikohet me ligj, pranimet në universitet koordinohen nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Universiteti ndjek një politikë të përgjithshme lidhur me pranimet pasuniversitare, **[Dok.: 1.1: Rregullorja, Neni 56.2]** me kritere të detajuara për pranimin në universitet, të cilat përcaktohen në dokumentacionin për secilin program dhe publikohen në faqet e internetit të secilit fakultet dhe nëpër postera. **[Dok.: RVV, fq.30-31, 39, Rregullore për programet e studimit, Master i Shkencave në Letërsi, neni 7; 3.4, Modalitetet për hapjen dhe krijimin e një programi të ri studimi; <http://uniel.edu.al/index.php/al/njofitime-shkencat-humane>: Fakulteti i Shkencave Humane: kontrolluar: 9/10/16] [ESG 1.4 Pranimi i studentëve]**
- 3.4 Përmbajtja dhe vlerësimi i programit shqyrtohet dhe përditësohet çdo vit, për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës. **[Dok.: 1.15 Analiza e Treguesve të Veprimtarive të Kërkimit dhe Mësimdhënies 2014-2015]** Miratimi i komisioneve kalon nëpër një proces të qartë, duke filluar nga niveli i departamentit dhe duke vazhduar në rang ngjitës në Këshillin e Fakultetit dhe Senat. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi që përditësimi i vazhdueshëm i programeve akademike, duke marrë parasysh informacionin e dhënë nga industritë partnere, që çon rrjedhimisht në përmirësimin e programeve dhe mundësive të punësimit për të diplomuarit, ishte realizuar mjaft mirë. **Dok.: RVV, fq.15, fq.28, Dok.: 1.1, Rregullore, nenet 37.1 dhe 38.3, Dok.: 2.7, Shembull i një analize vjetore të ndërmarrë nga departamentet (në shqip); Dok. 7, Termat e Referencës të Këshillit të Fakultetit; Mbledhjet 3 dhe 6] [ESG 1.2, Përgatitja dhe miratimi i programeve]**
- 3.5 Edhe pse çështjet që theksohen në vlerësimet vjetore renditen në mënyrë sistematike dhe shoqërohen shpesh edhe me komente të detajuara, nuk përcaktohen veprime të qarta për rezultatet që duhen arritur, gjë që nënkupton paqartësinë e përmirësimeve që do të zbatohen dhe të mënyrës se si do të monitorohet ky proces. Për këtë arsye, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm sugjeron që universiteti të përforcojë vlerësimet vjetore, duke miratuar plane veprimi me objektivat e qarta që duhen arritur, si dhe duke garantuar që zbatimimi i tyre të monitorohet në mënyrë sistematike dhe transparente nga komisionet përkatëse.
- 3.6 Universiteti përcakton rregulla dhe procedura të qarta vlerësimi. Rezultatet e programit vlerësohen përmes vlerësimit të vazhdueshëm, provimeve përfundimtare të modulit dhe një teze përmbyllëse. **[Dok.: 100, Rregullore, nenet 45.4 & 46-55; 1.1.3, Vlerësimi i cilësisë së njohurive të studentëve, Shtojca 1 e Rregullores]** Fakultetet kanë rregulloret e veta për vlerësimin. **[Dok.: 39, Rregullore për programet e studimit, Master i Shkencave në Letërsi, Nenet 21-44] [Kapitulli I Standardi I.1]**
- 3.7 Universiteti nuk ofron aktualisht rritje profesionale në vazhdim dhe formime afatshkurtra, edhe pse kjo gjë po zhvillohet gradualisht. **[Dok.: RVV, fq.38]** Partnerët e tjerë

në fushën e arsimit konfirmuan planet për ofrimin e formimit profesional pedagogjik për mësuesit e shkollës së Elbasanit.[Dok.: RVV, fq.28] [Kapitulli I Standardi I.2]

- 3.8 Për shkak të një vendimi të marrë nga ministria, universiteti i ka mbyllur programet me kohë të pjesshme për studentët që prej vitit 2014, duke pakësuar kështu financimet e ofruara nga universiteti. Programi i vetëm që ka mbetur në ciklin të parë me kohë të pjesshme lidhet me kurset e vitit të tretë, që aktualisht është në proces e sipër.[Dok.: RVV, fq.28; Mbledhja 2]
- 3.9 Strategjia e Zhvillimit të universitetit përshkruan objektivat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të programeve dhe kualifikimeve akademike. Kriteret përfundimtare për diplomën parashtrihen qartë në Rregulloret e Universitetit [Dok.1.1: Rregullore, Nenet 60-65] dhe i bëhen të ditura studentëve me anë të dokumentacioneve të programeve [Dok.: 39, Rregullore për programet e studimit, Master i Shkencave në Letërsi, Nenet 32-44] ose përmes udhëzimeve të posaçme për diplomën. [Dok.: 4.3, Manual për përgatitjen e diplomës; 41, Përgatitje e diplomës në Master i Shkencave (Fakulteti i Shkencave Humane)] [Kapitulli I Standardi I.3] [ESG 1.4, Kalueshmëria e studentëve, Njohja dhe certifikimi]
- 3.10 Strategjia dhe politikat e universitetit i përshtaten prirjeve të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar. Kjo përfshin monitorimin e kërkesave të tregut, promovimin e të mësuarit të kulturës dhe gjuhës së huaj, dhe zhvillimin e programeve ndërdisiplinore. Secili program studimi përfshin një ose dy gjuhë të huaja. [RVV, fq.29] Universiteti ka krijuar edhe programe ndërdisiplinore me titull të përbashkët, për shembull, Histori dhe Gjeografi [Dok.:3.1 Lista e programeve të studimit] dhe së fundmi, janë krijuar programe të reja të integruara, duke kombinuar studimin e gjuhës me një disiplinë, për shembull, Histori dhe Gjuhë Gjermane. [Dok.: RVV, fq.29] [Kapitulli I Standardi I.4]
- 3.11 Secili pedagog diskuton dhe bie dakord për ngarkesën mësimore me Përgjegjësin e Departamentit, në përputhje me aktet nënligjore qeveritare. Qëllimi është të arrihet një shpërndarje sa më e ekuilibruar e orëve ndërmjet mësimdhënies, kërkimit dhe administrimit. [Dok.: RVV, fq.30; 3.3 Marrëveshje për organizimin e ngarkesës mësimore vjetore; Dokumenti 3.4 Modalitetet për hapjen e një programi të ri studimor] Orët shtesë financohen nga burimet e vetë universitetit. [Dok.: RVV, fq.30] [Kapitulli I Standardi I.5]
- 3.12 Kriteret e studimit përcaktohen mjaft qartë. Dokumentimi i programit përfshin objektivat e lëndëve, kompetencat, metodat e mësimdhënies, orët dhe kreditet mësimore ECTS të ndara sipas semestrave, personelit dhe përgatitjes së diplomave. [Dok.: 31, Modalitetet për hapjen e një programi të ri studimi të ciklit të dytë; 30] Studentët konfirmuan se informacionet rreth programeve të studimit aksesosheshin dhe kuptoheshin lehtësisht falë dokumentimit zyrtar, posterave dhe sistemit EMS, Sistemit të Menaxhimit të Mësimdhënies të zhvilluar mjaft mirë nga universiteti, i cili u jep studentëve dhe personelit akses të drejtpërdrejtë në një rrjet të gjerë të të dhënave të studentëve (duke përfshirë edhe rezultatet e provimeve), oraret mësimore, komunikimet dhe burimet e të nxënit. [Dok.: Mbledhjet 4 & 5; Shënim 10, Demonstrim/Turi i Sistemit të IT-së; 1.4, Rregullore e funksionimit të sistemit EMS] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e identifikoi sistemin gjithëpërfshirës EMS të universitetit, i cili u jep studentëve dhe personelit një pikë të vetme aksesit tek informacionet bazë të studimit, si karakteristikë të praktikës së mirë. [Kapitulli III, Standardi I.6]
- 3.13 Hartimi i programeve të studimit lehtëson ecurinë nga njëri vit në tjetrin. Kriteret e pranimit për në programin Master përcaktohen qartë. [Dok.: 40, Programet e ciklit të parë, të cilët i kualifikojnë studentët për të vazhduar në programet e ciklit të dytë] Të gjitha programet kanë si kriter përfundimtar me sukses të një faze për të kaluar në një fazë tjetër më të lartë. Programet e ciklit të parë i pajisin studentët me njohuritë bazë të metodave dhe parimeve shkencore, dhe me aftësi të specializuara profesionale. [Dok.: 1.1: Rregullore, Neni 24] Gjithashtu, studentëve iu ofrohet edhe praktika profesionale, që zgjat katër deri në pesë javë, e cila i ndihmon ata t'i vënë njohuritë teorike në praktikë, duke i përgatitur për karrierën në të ardhmen. [Dok.: RVV, fq.33, fq.36, fq.38; 4.2 Procedurat e praktikës]

studentore (AL); Mbledhja 4] Në mbështetje të kësaj, dokumentacioni i programit të ciklit të parë përkufizon edhe kompetencat e punësimit.**[Dok.: 31, Modalitetet për hapjen e një programi të ri studimi të ciklit të dytë, fq.5]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron si karakteristikë të praktikës së mirë mundësinë që i ofrohet studentëve për t'u angazhuar në praktika profesionale dhe stazhe, pasi e ndihmojnë studentin të përgatitet për punësim në të ardhmen dhe garanton dhënien e kontributit në ekonominë vendore nga ana e universitetit.**[Kapitulli I, Standardi I.7]**

- 3.14 Universiteti ka edhe një sistem bursash, në përputhje me aktin nënligjor qeveritar nr. 911 për të lehtësuar përfshirjen sociale.**[Dok.: RVV, 32; 1.14, Strategjia e Zhvillimit të UE-së, p.3; Mbledhja 4]** Bursat u jepen disa grupeve të veçanta sociale, si p.sh në rastin e studentëve romë dhe egjiptianë të Ballkanit, që nuk paguajnë tarifën e shkollimit, **[Mbledhja 4]** si dhe disa studentëve për arritjet akademike.**[Dok.: RVV, fq.32]**
[Kapitulli I Standardi I.8]
- 3.15 Mbështetja për studentët ofrohet përmes javës së orientimit fillestar dhe mundësive javore për tutorim nga stafi akademik.**[Dok.: RVV, fq.48-9; 1.1: Rregullore, Neni 58.9; Mbledhjet 4, 6 dhe 9]** Qendra e Këshillimit Studentor jep këshilla për karrierën **[Dok.:RVV, fq.32, Mbledhja 9]**, ndërsa Avokati i Studentëve garanton ngritjen e shqetësimeve të studentëve në mbledhjet përkatëse.**[Dok.: RVV, fq.32; Mbledhjet 4 dhe 8]** Studentët e ciklit të parë e përshkruanin kulturën e universitetit gjatë javëve të para si mirëpritëse, që përfshinte edhe një prezantim të shkurtër të drejtuar nga Dekani, **[Mbledhja 9]** dhe ofrimin e mundësive joformale për të pyetur te sekretaritet e fakulteteve ose përfaqësuesi i studentëve.**[Mbledhja 4]** Edhe studentët e diplomuar e përshkruanin kulturën e universitetit si mirëpritëse, por ata mbështeteshin më shumë të ndërveprimi që kishin me tutorin individual për orientim dhe udhëzim.**[Mbledhja 5]** Për ta përmirësuar këtë gjë, grupi i vlerësimit të jashtëm sugjeron që universiteti ta përvetësojë orientimin e studentëve në mënyrë më sistematike, për të garantuar përvojë të njëjtë për të gjithë studentët.
- 3.16 Ndonëse metodat tradicionale të mësimdhënies udhëzuese vazhdojnë të mbizotërojnë, personeli përpiqet gjithnjë e më shumë të zbatojë qasje me në qendër studentin, për shembull qasjet ndërvepruese. Krahas përmirësimit të ofertës së formimit të pedagogëve dhe ndarjes së saj me stafin akademik, universiteti është angazhuar edhe në disa nisma zhvillimi afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të mësimdhënies.**[Dok: 1.14, Strategjia e Zhvillimit të UE-së, fq.1, p.3]**
- 3.17 Për sa i përket mësimdhënies së ofruar në ciklin e parë dhe të dytë, 68 për qind e stafit akademik është punësuar me kohë të plotë.**[Dok.: 3.5, Statistikat për realizimin e ngarkesës mësimore (në gjuhën shqipe)]** Pjesa më e madhe e pedagogëve të ciklit të dytë dhe të tretë kryejnë veprimtari kërkimore dhe marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e programeve të studimit. **[Dok.: RVV, fq.33]** Strategjia e Zhvillimit përpiqet të rrisë nivelin e kualifikimeve të stafit akademik ekzistues dhe atij të ri.**[Dok.: 1.14, Strategjia e Zhvillimit të UE-së, fq.1, pika1, 2 & 4]** Përkatësisht, sistemi i pikëzimit të politikës për punësimin e personelit favorizon ata persona që kanë nivel më të lartë kualifikimi.**[Dok.: 1.3, Modalitetet dhe standardet për punësimin e stafit akademik, fq.3]** **[Kapitulli I Standardi I.9]**
- 3.18 Të gjitha propozimet për ofrimin e programeve të reja të Masterit të Shkencave duhet të jenë të përshtatura në mënyrë strategjike me politikat që ndjek universiteti për sa i përket kërkimit shkencor dhe duhet të mbështeten nga veprimtari të veçanta kërkimore të ndërmarra nga personeli, gjë që ofron mundësi për kërkim të qëndrueshëm.**[Dok.: RVV, fq.32; 3.4, Modalitetet për hapjen dhe krijimin e një programi të ri studimi]** **[ESG 1.2, Struktura dhe miratimi i programeve]**
- 3.19 Mundësitë e punësimit përcaktohen në dokumentacionin e programit.**[Dok.: 31, Modalitetet për hapjen e një programi të ri studimi të ciklit të dytë]** Praktika profesionale, duke përfshirë edhe stazhet, realizohet në bashkëpunim me organizatat e punëdhënësve vendorë, për shembull bankat dhe zyrat e tatimeve.**[Dok.: 3.8, Lista e marrëveshjeve për praktikat profesionale (në gjuhën shqipe)]** Në fund të praktikës,

punëdhënësi plotëson një formular vlerësimi për performancën e studentëve. **[Dok.: RVV, fq.33; Mbledhjet 4 dhe 7] [Kapitulli I Standardi I.12]**

- 3.20 Universiteti synon të ndjekë rezultatet e punësimit të alumnit të tij. **[1.14, Strategjia e Zhvillimit të UE-së, fq.1; 1.15, Analiza e treguesve të veprimtarive të kërkimit dhe mësimdhënies, 2014-15, fq.3; Mbledhja 2, Rektori]** Megjithatë, për këtë pikë, nuk ka asnjë departament përgjegjës dhe të dhënat janë të paplota. Universiteti deklaron hapur që është në kërkim të mënyrave për të përmirësuar procesin, **[Dok.: RVV, fq.33; fq. 16,34 dhe 41]** gjë që u konfirmua edhe nga personeli. **[Mbledhja 9, Personeli mbështetës]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i identifikon si **dobësi** të dhënat e paplota për punësimin e të diplomuarve, që mund të pengojnë marrjen e informacionit mbi tregun, rishikimin e kurrikulës dhe planifikimin për të ardhmen. Për këtë arsye, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që universiteti të punojë për të ndjekur një qasje më sistematike për mbledhjen e plotë ose pothuajse të plotë të të dhënave rreth punësimit të të diplomuarve, në mënyrë që t'i kuptojë më mirë prirjet e tregut dhe t'i pasqyrojë ato në ndryshimet e kurrikulës. **[Kapitulli I, Standardi I.9]**
- 3.21 Për sa i përket programeve të Masterit Profesional, universiteti punëson mjekë për të ofruar një mësimdhënie profesionale sa më eksperte, për shembull, leksionet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike në programet e Masterit Profesional jepen nga mjekë. **[Dok.: RVV, fq.34; Mbledhjet 7 dhe 8]**
- 3.22 Programet e të gjitha niveleve janë në përputhje me Procesin e Bolonjës. Të diplomuarve të programeve të ciklit të parë dhe të dytë iu jepet diploma dhe suplementi i diplomës në gjuhën angleze dhe shqipe. **[Dok.: RVV, fq.25]** Universiteti i informon studentët rreth transferimit të krediteve dhe programeve përmes një linku online **[Dok.: RVV, fq.31; Mbledhja 4]** dhe i lejon ata që vijnë nga universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit të transferojnë kreditet. Kjo e fundit është e realizueshme për shkak të njehsimit të kurrikulës: në rastin e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, 70 për qind e kursit të studimit është hartuar në mënyrë të tillë që të përputhet me kurse të ngjashme të ofruara nga universitete të tjera. **[Dok.: RVV, fq.35]** Në rast se është lidhur një marrëveshje partneriteti, kreditet mund të transferohen automatikisht pa iu nënshtuar një vlerësimi të posaçëm. **[Dok.: RVV, fq.35] [Kapitulli I Standardi I.10]**
- 3.23 Si pjesë e politikës së ndërkombëtarizimit, studentët e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë i nënshtrohen provimit të gjuhës së huaj, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë. **[Dok.: RVV, fq.35]**
- 3.24 Programet e studimit strukturohen në mënyrë të tillë që të mund të lejojnë zbatimin e rregullave teorike përmes praktikës profesionale. Studentët dhe punëdhënësit konfirmuan se ky proces funksionon me efikasitet, si në rastin e formimit të mësuesve. **[Dok.: Mbledhja 4 dhe 7]** Studentët kanë mundësi të marrin pjesë edhe në projekte kërkimore të drejtuara nga personeli dhe nëpër konferenca. **[Dok.: RVV, fq. 32; 1.14, Strategjia e Zhvillimit të UE-së, p.4; Mbledhja 6] [Kapitulli I, Standardi I.11]**
- 3.25 Misioni i universitetit përqendrohet në një kurrikulë, e cila mbështet prioritetet e tregut kombëtar dhe rajonal të punës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi si praktika të mira sistemin EMS të universitetit, i cili i jep studentëve dhe personelit një pikë të vetme aksesit të të dhënave kryesore të studentëve; si dhe mundësitë që iu ofrohen studentëve për t'u angazhuar në praktika profesionale dhe stazhe, të cilat e ndihmojnë studentin për punësimin në të ardhmen dhe garantojnë dhënien e kontributit nga ana e universitetit në ekonominë vendore. Si dobësi u identifikuan të dhënat e paplota për punësimin e të diplomuarve, që mund të pengojnë marrjen e informacionit mbi tregun, rishikimin e kurrikulës dhe planifikimin për të ardhmen. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që universiteti të punojë për të ndjekur një qasje më sistematike për mbledhjen e plotë ose pothuajse të plotë të të dhënave rreth punësimit të të diplomuarve, në mënyrë që t'i kuptojë më mirë prirjet e tregut dhe t'i pasqyrojë ato në ndryshimet që pëson kurrikula. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se standardet për Kurrikulën janë përbushur plotësisht.

Gjetjet

Praktikat e mira

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi tiparet e mëposhtme të praktikës së mirë:

- sistemi gjithëpërfshirës EMS i Universitetit, që i ofron studentëve dhe personelit një pikë të vetme aksesit tek informacionet kryesore të studimit (pika 3.12)
- ofrimi i mundësive për t'i angazhuar studentët në praktika profesionale dhe stazhe, të cilat i ndihmojnë ata të përgatiten për punësim në të ardhmen, dhe garantojnë dhënien e kontributit nga ana e universitetit në ekonominë vendore. (pika 3.13).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- të dhëna të paplota për punësimin e të diplomuarve, që mund të pengojnë marrjen e informacionit mbi tregun, rishikimin e kurrikulës dhe planifikimin për të ardhmen (pika 3.20).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- universiteti duhet të punojë për të ndjekur një qasje më sistematike për mbledhjen e plotë ose pothuajse të plotë rreth punësimin të të diplomuarve, në mënyrë që t'i kuptojë më mirë prirjet e tregut dhe t'i pasqyrojë ato në ndryshimet e kurrikulës (pika 3.20).

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë lidhur me këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- 4.1 Në fund të çdo viti akademik, departamentet rishikojnë programet e tyre dhe identifikojnë ato pjesë që kanë nevojë për më shumë përmirësim, duke përfshirë edhe listën e materialeve për lexim për secilin modul të programit. **[Dok.: 1.1, M3 Personel i nivelit të lartë, Dokumente shtesë 1.15 Raport i analizës për vitin 2014-2015]** Procesi i rishikimit të programeve të studimit në departament vlerësohet nga stafi akademik. **[Dok.: 2.20, M3 Personel i nivelit të lartë, M8 me Përgjegjësit e Departamenteve, M3 Personel i nivelit të lartë]** Një prej rezultateve pozitive është se universiteti garanton një organizim të strukturuar mirë dhe dokumentim të saktë të përmbajtjes së programit për çdo program studimi. **[Kapitulli I Standardi II.1]**
- 4.2 Universiteti arrin ta realizojë pjesën më të madhe të procesit të mësimdhënës në godinat e tij, megjithëse disa prej laboratorëve ndodhen në zona të tjera dhe përdoren në përputhje me marrëveshjet e bashkëpunimit me punëdhënësit vendorë. **[Dok.: 3.8, M3 Personel i nivelit të lartë, M8 me Përgjegjësit e Departamenteve, M7 Përfaqësuesit e jashtëm]** Ky bashkëpunim me institucionet vendore, qoftë publike ose private, është i zhvilluar mjaft mirë. Fakultetet në veçanti dhe universiteti në tërësi ka lidhur marrëveshje me partnerët edhe për praktikantët, duke u mbështetur në zhvillimin e rrjetit të punëdhënësit. **[Dok.: 4.2, M7 përfaqësues të jashtëm, M8 me Përgjegjësit e Departamenteve, M5 Studentët][Kapitulli I Standardi II.2]**
- 4.3 Përveç bibliotekës qendrore të universitetit në kampusin kryesor, çdo fakultet ka bibliotekën e vet. Departamentet përkatëse garantojnë akses dhe saktësi informacioni për studentët. **[Dok.: 2.16 Lista e pasurive të paluajtshme të UE-së; 4,6 Propozim-buxheti; 5.3-Lista e pasurimit më të fundit të literaturës]**
- 4.4 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi se Universiteti i Elbasanit po punon për rritjen e cilësisë së tij përmes përmirësimeve të vazhdueshme që po ndërmerren në nivel departamenti, fakulteti dhe rektorati. **[Dok.: M2 Rektori; M8 Përgjegjësit e Departamenteve]** Ky proces mbështetet edhe përmes informacionit të përfutur nga anketime të ndryshme dhe monitorimit vjetor të programit, të cilat përfshijnë vlerësimin e studentëve, vlerësimin e pedagogëve, rezultatet e pyetësorëve dhe analizat e performancës së studentëve. **[Dok.: 2.7, M5 studentët, M9 Personeli i regjistrimeve dhe mbështetës][Kapitulli I Standardi II.3]**
- 4.5 Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies bëhet edhe nëpërmjet mobilitetit të personelit, punësimit të stafit akademik, promovimit të personelit, lejeve sabbatike dhe angazhimit të stafit akademik në projekte kërkimore. Kjo gjë, pasqyrohet në Statutin e Universitetit, rregulloret e departamentit dhe proceset vjetore të vlerësimit të departamenteve. **[Dok.: 1.1, M2 Rektori, M3 Personeli i nivelit të lartë, M8 Përgjegjësit e departamenteve][Kapitulli I Standardi II.4]**
- 4.6 Universiteti e kryen vlerësimin e personelit sipas një procedure të caktuar. Zëvendës Rektori vlerëson çdo vit performancën e pedagogëve, dhe këta të fundit e vlerësojnë vetë punën e tyre, duke plotësuar një formular personal vetëvlerësimi. **[Dok.: RVV fq 41; 2.7, 2.8; M2 Rektori; M3 Personel i nivelit të lartë; M8 Përgjegjësit e departamenteve]** Aktualisht, universiteti nuk ka struktura mbështetëse për promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e ka identifikuar këtë gjë si **dobësi**. **[Dok.: RVV 41; M5 Staf akademik, M3 Personel i nivelit të lartë]** Ndonëse Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vuri re se kishte hapësira për forma të tjera për zhvillimin dhe formimin e personelit, duke përfshirë seancat e vazhdueshme për formimin e personelit, të drejtuara nga pedagogët me përvojë të universitetit, ose nga pedagogët e ftuar nga universitetet brenda dhe jashtë vendit **[M5 Staf akademik, M3 Personel i nivelit të lartë]**, ata e identifikuan si **dobësi** faktin që personeli nuk trajnohej për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. **[Standard II.4]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** krijimin e një programi për rritjen profesionale të personelit në pedagogji. Mungesa e këtij programi mund të rrezikojë Standardin 2.4. Çdo punëmarrës ka të drejtë të përfitojë shtatë

ditë leje të paguara në çdo vit akademik, për të marrë pjesë në konferenca, seminare dhe seanca formimi. Departamentet i nxisin dhe i mbështesin anëtarët e stafit që të zhvillojnë aftësitë e tyre në mësimdhënie. **[Dok.: M5 Staf akademik, M3 Personeli i nivelit të lartë, 1.1 Statuti]**

- 4.7 Studentët e vlerësojnë performancën e pedagogëve dhe programet e studimit nëpërmjet pyetësorëve vjetor të organizuar nga Rektorati dhe Njësia e Sigurimit të Cilësisë. **[Dok.: M3 Personeli i nivelit të lartë, M8 Përgjegjësit e departamenteve; M5 Studentët]** Të dhënat e anketimit të studentëve ndihmojnë në vlerësimin e plotë të anëtarëve të stafit të mësimdhënies dhe përdoren për organizimin e veprimtarive të posaçme për formimin dhe rritjen profesionale të këtij stafi. **[Dok.: M8 Stafi akademik, M3 Personeli i nivelit të lartë]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm sugjeron si një metodë përforsimi, përfshirjen e pyetësorëve me feedback-un e studentëve, mbi të cilat do të mbështeten përmirësimet që duhet të pësojë cilësia e kërkimit dhe mësimdhënies.
- 4.8 Universiteti organizon grupe për kërkimin shkencor, për rritjen e përpjekjeve për përcaktimin e kritereve të punësimit të stafit akademik me tituj akademik përmes veprimtarive kërkimore. Monitorimi i veprimtarive kërkimore kryhet zakonisht çdo vit në nivel departamenti, për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta në fushën e përpjekjeve shkencore. **[Dok.: 1.14 Strategjia e Zhvillimit, M5 Staf akademik, M3 Personeli i nivelit të lartë, M8 Përgjegjësit e departamenteve]** Departamentet kanë buxhet të kufizuar, **[Dokument M3 Personeli i nivelit të lartë, M8 Përgjegjësit e departamenteve]** pavarësisht përgatitjes së strategjive të tyre në mbështetje të akteve nënligjore, për të përforcuar autonominë dhe për të përmirësuar veprimtarinë e tyre kërkimore. **[Dok.: M3 Personel i nivelit të lartë, Raport për veprimtarinë kërkimore shkencore] [Kapitulli II Standardi I.1]**
- 4.9 Departamentet janë njësitë themelore të universitetit, dhe si të tilla luajnë rol të rëndësishëm në nxitjen e veprimtarisë kërkimore të personelit të tyre. **[Dok.: 1.1 Rregullore e Fakultetit, Rregullore e Brendshme e Departamentit- Rregullore e funksionimit, organizimit dhe administrimit të Universitetit të Elbasanit]** Ata i përcaktojnë prioritetet e tyre të kërkimit, duke u konsultuar me institucionet kërkimore të krijuara së fundmi. **[Dok.: RVV fq.43, Rregullore e Fakultetit, Rregullore e Brendshme e Departamentit]** Për të mbështetur më tej këtë fushë zhvillimi, universiteti po nxit angazhimin dhe pjesëmarrjen në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e **pohon** këtë zhvillim, i cili, në rast të kundërt, do të rrezikonte Standardin 1.3. **[Dok.: 4.6, M3 Personeli i nivelit të lartë, Raport për veprimtarinë kërkimore] [Kapitulli II Standardi I.2; I.3]**
- 4.10 Universiteti e lehtëson ndërkombëtarizimin e kërkimit të tij shkencor përmes marrëveshjeve dhe pjesëmarrjes nëpër projekte me partnerë të ndryshëm. **[Dok.: 1.13, M2 Rektori; M3 Personeli i nivelit të lartë; M6 Staf akademik; M8 Përgjegjësit e Departamenteve]** Përpjekjet për tërheqjen e fondeve të jashtme kanë qenë të suksesshme, duke përfshirë programet Tempus dhe Erasmus +. Nëpërmjet kuadrit të programit Erasmus, universiteti bashkëpunon me universitete private dhe publike në Shqipëri dhe në Evropë, si dhe ka krijuar rrjete partnerësh për çështje që lidhen me qeverisjen qendrore dhe vendore, biznesin, ligjin dhe ekonominë kombëtare. **[RVV fq 43; M5 studentët] [Kapitulli II, Standardi I.3]**
- 4.11 Prioritetet e kërkimit dhe financimi diskutohen në nivel departamenti dhe qendre kërkimore. Propozimet parashtrohen për shqyrtim dhe miratim nga Rektorati. Universiteti po përpiqet të punësojë staf akademik me kualifikimet dhe përvojën e duhur, si dhe të mbështesë dhe nxisë pjesëmarrjen e studentëve në kërkim. Për ta mbështetur më tej bazën kërkimore dhe politikën e ndërkombëtarizimit, universiteti po përpiqet të integrojë ndërkombëtarizimin e kërkimit shkencor përmes marrëveshjeve të ndryshme me partnerë të ndryshëm **[Dok.:4.7- Informacion për konferencat shkencore të organizuara nga UE-ja]** për të integruar kërkuesit e huaj dhe për të nxitur mobilitetin e stafit të tij akademik. **[Dok.: M2 Rektori, M3 Personeli i nivelit të lartë M6 Stafi akademik; M8 Përgjegjësit e departamenteve] [Kapitulli II Standardi I.4]**

- 4.12 Prioritetet e kërkimit të universitetit udhëhiqen nga departamentet dhe qendrat kërkimore. Mbështetet pjesëmarrja e stafit dhe studentëve nëpër konferenca shkencore. Anëtarëve të stafit i caktohet koha e posaçme për kërkim në ngarkesën e tyre mësimore vjetore. **[Dok. M8 Përgjegjësit e departamenteve; M6 Stafi akademik]** Çdo vit, personelit i kërkohet të prezantojë punën e tij në të paktën një konferencë shkencore të brendshme, ose të publikojë një artikull shkencor në një revistë. **[Dok.v: 1.15 - Analiza e Treguesve të Veprimtarive të Kërkimit dhe Mësimdhënies 2014-2015] [Kapitulli II Standardi I.5]**
- 4.13 Universiteti ka një sistem informacioni online për veprimtaritë kërkimore dhe botimet e stafit, dhe çdo vit, departamentet publikojnë një listë të veprimtarive shkencore dhe botimeve të tyre. **[Dok.: Raport vjetor, Botimet; M3 Personel i nivelit të lartë; M6 Stafi akademik; M8 Përgjegjësit e departamenteve][Kapitulli II Standardi I.6]**
- 4.14 Universiteti boton Buletinin Shkencor, numrat e të cilit janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe mbështet botimin e rezultateve kërkimore, të cilat botohen në revistën dhe faqen e tij të internetit.**[Dok.: RVV fq 46][Kapitulli II Standardi I.7]**
- 4.15 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon përgatitjen e planit strategjik, **[Dokumenti 1.14; M2 Rektori; M3 Personeli i nivelit të lartë; M6 Stafi akademik; M8 Përgjegjësit e departamenteve]** i cili paraqet aspiratat e ardhshme për kërkimin dhe zhvillimin e punës individuale të stafit akademik, si në afate të shkurtra, ashtu edhe në afate të gjata.**[Kapitulli II, Standardi I.8]**
- 4.16 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se dokumentacioni për çdo program studimi ishte përgatitur mjaft mirë, dhe se procesi për formimin praktik dhe profesional ishte i qartë, duke përfshirë këtu bashkëpunimin me institucione të tjera vendore. Për sa i përket dobësive, ndonëse personeli kishte hapësira për t'u angazhuar në forma të ndryshme trajnimi, ende nuk është krijuar një strukturë formale për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që të trajtohet kjo Fushë Vlerësimi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm sugjeron se pyetësorët dhe feedback-u i studentëve mund të shfrytëzohen më mirë në përcaktimin e përmirësimeve që duhet të pësojë kërkimi dhe mësimdhënia, një problem ky i identifikuar edhe nga vetë universiteti. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i identifikoi përmirësimet e vazhdueshme të cilësisë, përmes veprimeve të ndërmarra në nivele të ndryshme dhe të planit strategjik me objektiva të qarta, si nisma dhe zhvillime në proces e sipër. Nismat ndërkombëtare, qasjet eklektike dhe krijuese për kërkimin dhe botimet e personelit janë identifikuar në këtë fushë vlerësimi si prioritete zhvillimi.

Gjetjet

Praktikat e mira

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë në këtë Fushë Vlerësimi.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- universiteti nuk ka struktura mbështetëse për nxitjen e përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies (pika 4.6).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- universiteti duhet të krijojë një strukturë formale për nxitjen e përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies (pedagogjia) (pika 4.6).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e ndërmarrë si më poshtë:

- universiteti nxit angazhimin dhe pjesëmarrjen nëpër konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare (pika 4.9).

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

- 5.1 Universiteti ka ngritur Qendrën e Këshillimit të Karrierës (QKK). Kjo është zyra qendrore që ofron mbështetje dhe merret me pranimin e studentëve të rinj. Megjithatë, në praktikë, QKK-ja ofron mbështetje akademike dhe i informon studentët rreth mundësive të studimit jashtë vendit përmes lidhjeve që ka universiteti, duke përfshirë edhe lidhjet me ambasadat në Republikën e Shqipërisë, kurset verore dhe burimet për mbështetjen e studimeve. Kjo qendër menaxhon edhe testin e gjuhës angleze. Qendra ka marrëdhënie të ngushta edhe me komunitetet e biznesit. **[Dok.: Mbledhja 9]** Aktualisht, QKK-ja nuk funksionon si një strukturë për pritjen, informimin dhe pranimin e studentëve të rinj dhe atyre aktualë në programet Bachelor. Po ashtu, universiteti nuk ka me një strukturë të posaçme për programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë për informimin dhe orientimin e studentëve të rinj. Për këto nivele dhe cikle të avancuara studimi, studentët informohen dhe ndihmohen nga pedagogët mbikëqyrës. **[Dok.: RVV, fq.47; Mbledhja 5]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm sugjeron, si metodë përmirësimi, që kjo strukturë të rishikohet si një strukturë që ofron pritjen, informimin dhe orientimin e të gjithë studentëve. **[Kapitulli I Standardi III.1]**
- 5.2 Sekretariatë Mësimore të secilit fakultet dhe departamentet e tyre luajnë rol të rëndësishëm në orientimin e studentëve dhe dhënien e informacioneve rreth çështjeve të ndryshme që lidhen me studentët. **[Dok. 1.1: Neni. 58, pika 9 Rregullore e funksionimit, organizimit dhe administrimit të Universitetit të Elbasanit.pdf; RVV fq.48; Mbledhja 4, 5] [Kapitulli I Standardi III.1]**
- 5.3 Për mirëpritjen e studentëve të rinj, çdo vit akademik, universiteti organizon ditët e hapura. Këto aktivitete publikohen në faqen e internetit të universitetit. **[Dokumenti 2.6: Plani i aktiviteteve për Fakultetin e Shkencave të Edukimit Ditët e Hapura (Prill Maj 2015)]** Në ditën e parë, dekani dhe pedagogët e secilit fakultet bëjnë prezantohen, shpjegojnë planin e tyre, ndërsa Sekretaria Mësimore i udhëheq studentët drejt burimeve dhe vendeve përkatëse. **[Dok: Mbledhja 4] [Kapitulli I Standardi III.1]**
- 5.4 Universiteti publikon grafikun e takimeve me studentët e rinj, i cili zbatohet nga Sekretaria Mësimore e secilit fakultet. **[RVV, fq.48] - [Mbledhjet 4, 5, 9]** Përgjegjësi i departamentit, zëvendës dekani dhe dekani i ndihmojnë studentët sipas nevojës dhe rastit. **[Dok: Mbledhja 3, 8] [Kapitulli I Standardi III.1]**
- 5.5 Universiteti ka krijuar një formë komunikimi të brendshme përmes sistemit të bazës së të dhënave EMS, i cili mundëson komunikimin midis studentëve dhe stafit akademik apo personelit administrativ, ku mund të ndajnë me njëri-tjetrin materialet e kursit, në mënyrë individuale ose në grupe. **[Dok.: 1.4: Rregullore e funksionimit të sistemit EMS; Mbledhja 11]** Fakulteti Ekonomikut boton një buletin informues **[RVV, fq.48]** si dhe ka edhe faqe në rrjete sociale. Stafi akademik dhe personeli administrativ kanë një adresë të brendshme elektronike: emër.mbiemër.uniel.edu.al **[Dok.: RVV, fq.48] [Kapitulli I Standardi III.2]**
- 5.6 Dosja personale e çdo studenti ruhet në Sekretarinë Mësimore. Kjo dosje përditësohet gjatë periudhës së studimit, duke përfshirë hollësitë për praktikën profesionale dhe temën e diplomës. Universiteti duhet të ruajë të dhënat e plota të kontaktit për të gjithë studentët. **[Dok.: RVV, fq.48; Mbledhjet 4, 5, 11]** Si pasojë, për sa i përket anketimit të studentëve, ndërveprimi i studentëve ka qenë i ulët, pasi universiteti nuk arriti t'i jepte të dhënat e plota të kontaktit APAAL-it. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron këtë si dobësi dhe rekomandon që universiteti të krijojë një sistem gjithëpërfshirës të dhënash, duke përfshirë edhe të dhënat e plota të kontaktit për të gjithë studentët. **[Kapitulli I Standardi III.2]**
- 5.7 Departamentet, përmes stafit të tyre akademik, informojnë dhe orientojnë studentët për praktika të ndryshme të brendshme, si për shembull natyrën e vlerësimit, vlerësimet e vazhdueshme në lëndë dhe module specifike, vendin ku mund të gjenden materialet shtesë, apo mënyrën se si të përgatiten për të përmbushur kriteret dhe detyrimet e ndryshme që ka lënda dhe moduli. **[Dok: Mbledhja 6, 8] [Kapitulli I Standardi III.3]**

- 5.8 Megjithëse departamentet, si njësi bazë themelore të universitetit, ruajnë informacionet dhe kujdesen për orientimin e studentëve në lidhje me procesin mësimor, aktualisht, nuk ekziston asnjë rregullore për tutorimin dhe mentorimin individual për çdo departament në universitet. Një strukturë e posaçme institucionale do të nxiste dhe mundësonte një mbështetje akoma më të plotë për studentët, duke përfshirë punën individuale me studentët, e cila nevojitet gjatë udhëheqjes së temës së diplomës. **[Dok.: Mbledhjet 4, 5, 6]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm sugjeron që si metodë përmirësimi, universiteti të hartojë dhe miratojë një rregullore institucionale në kuadër të procesit të mentorimit dhe tutorimit për të gjithë studentët. **[Kapitulli I Standardi III.3]**
- 5.9 Në programin e studimit Master Profesional në Mësimdhënie, Fakulteti i Shkencave të Edukimit ka përgatitur një manual për temën e diplomës. Në këtë manual, të titulluar “Përgjegjësitë e pedagogut mentor”, parashtrihen kriteret, por këto kritere janë të një natyre të përgjithshme dhe nuk shoqërohen me hapat ose veprimet përcaktuese. Ky manual përdoret vetëm nga Fakulteti i Shkencave të Edukimit. **[Dok.: 4.3: Manual për përgatitjen e diplomës (Shqip)] [Kapitulli I Standardi III.3]**
- 5.10 Në kontekstin më të gjerë kurrikular, universiteti bashkëpunon me organizatat për të drejtat e njeriut për të mbështetur studentët që i përkasin komuniteteve romë dhe egjiptiane. **[Dok.: RVV, fq.50]** Për ta mbështetur këtë nismë, në Fakultetin e Shkencave Humane është hapur një program studimi Bachelor në Gjuhën Shqipe dhe Rome. **[Dok.:5.2: Modalitetet për hapjen e programit të studimit Bachelor në Gjuhën Shqipe dhe Rome (AL)]** Ky program studimi, i cili lehtëson integrimin e komunitetit rom në arsimin e lartë në Shqipëri, është shembulli i praktikës së mirë. **[Kapitulli I Standardi III.4]**
- 5.11 Universiteti vë në dispozicion materialet e leximit në formën e teksteve mësimore, të cilat miratohen nga çdo departament, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë. Biblioteka e universitetit ka një ndarje të dobishme dhe të posaçme që quhet “Tekstet Mësimore të Universitetit”. **[Dok.: Mbledhja 10: Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike [Kapitulli I Standardi III.5 & Kapitulli I Standardi III.6]**
- 5.12 Universiteti ka një bibliotekë qendrore, e cila është bashkëkohore dhe i përgjigjet nevojave të studentëve. **[Dok.: Mbledhja 10]** Sipas të dhënave të listës së fundit të blerjeve të literaturës, del se fondi i bibliotekës ka pasuruar burimet e tij. **[Dok.: 5.3]** Megjithatë, pjesa dërrmuese janë libra letrarë dhe jo tekste mësimore. Gjatë pasurimit të fundit që i është bërë bibliotekës, nuk u gjet asnjë dokument për shtimin e teksteve të reja shkollore gjatë vitit akademik 2015-2016 në Fakultetin e Ekonomikut, Fakultetin e Shkencave të Natyrës apo Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike. **[Dok.: 5.3]** Megjithatë, fondi i bibliotekës i ka të gjitha lehtësitë për pasurimin e bibliotekës me botimet e reja të teksteve mësimore, për t’iu përgjigjur nevojave të programeve të studimit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm njeherë përpjekjet aktuale që ka bërë universiteti për pasurimin e përgjithshëm të bibliotekës dhe përpjekjet për të garantuar që blerjet e teksteve mësimore të kenë të njëjtën peshë. **[Kapitulli I Standardi III.5]**
- 5.13 Rutina e punës së bibliotekës mbështetet në kërkesat që vijnë nga stafi akademik dhe studentët. Këta të fundit kanë tashmë një kartelë për librat e shtypur, por duhet t’iu caktohet edhe një kartelë elektronike për bibliotekën elektronike. **[Dok.: RVV, fq.51]** Krahas librave të shtypur, universiteti ka një dyqan librash elektronikë, i cili mund të gjendet në: www.uniel.edu.al/index.php/al/biblioteka-online. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson hapat që po ndërmerret biblioteka qendrore për të marrë financime për dixhitalizimin. **[Dok.: RVV, fq.51; Mbledhja 10][Kapitulli I Standardi III.5]**
- 5.14 Në mbështetje të kuadrit ligjor për arsimin e lartë në Shqipëri, universiteti ka mundësuar përfaqësimin e studentëve në strukturat universitare. Kështu, studentët përfaqësohen në mbledhjet e Senatit. **[Dokumenti 1.1 - Rregullore e funksionimit, organizimit dhe administrimit të Universitetit të Elbasanit.pdf, Neni 58, pika 2; 5.4:Vendimi i Komisionit për Zgjedhjet Institucionale për anëtarët e Senatit të UE-së (në shqip)] - [Mbledhja 4]** Studentët gëzojnë të drejtën të shprehin mendimet dhe shqetësimet e tyre për çështjet që lidhen me ecurinë e të nxënësve, duke përfshirë edhe mendimin e tyre lidhur me grafikët e provimeve. **[Mbledhjet 4, 5] [Kapitulli I Standardi III.7]**

- 5.15 Siç kërkohet dhe nga ligji për arsimin e lartë, studentët duhet të kenë një Këshill Studentor¹, **[Dok.: Ligji nr. 9741/2007 i ndryshuar, për Arsimin e Lartë, Neni. 55; Mbledhja 4]** por, gjatë takimit me studentët e programeve Bachelor dhe Master, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, konstatoi se studentët nuk kishin dijeni për ekzistencën e një këtij këshilli. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e identifikoi këtë gjë si **dobësi. [Dok.: Mbledhjet 4, 5][Kapitulli I Standardi III.7]**
- 5.16 Drejtuesit e nivelit të lartë të universitetit duhet t'i informojnë studentët për të drejtën e pasjes së një Këshilli Studentor (Qeveria Studentore), si struktura që promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të institucionit të arsimit të lartë në strukturat e mësimdhënies, si dhe në kërkim dhe shërbime. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm sugjeron, si një mënyrë për përmirësim, ngritjen e një Këshilli Studentor në çdo fakultet. Universiteti duhet të mbështesë Këshillin Studentor dhe të financojë veprimtaritë e tij. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që Këshilli Studentor të jetë efikas dhe përfaqësues, si dhe fuqizimin e tij për të shprehur mendimet dhe për të bërë propozime.**[Dok: RVV, fq.51] [Kapitulli I Standardi III.7]**
- 5.17 Universiteti përpiqet të ndjekë një politikë që mundëson pjesëmarrjen e studentëve në veprimtari kulturore, sipas kufizimeve të buxhetit.**[Dok.: RVV, fq.52]** Deri më sot, universiteti ka mbështetur financiarisht jetën kulturore të studentëve.**[Dok.: Mbledhjet 4, 6]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pranon përpjekjet që po bëhen në përputhje me mjetet financiare që ka universiteti.**[Kapitulli I Standardi III.8]**
- 5.18 Për të ndjekur politikën për lehtësimin e pjesëmarrjes së studentëve nëpër veprimtari kulturore, universiteti përpiqet të mbështesë veprimtaritë sportive. Kjo është bërë e mundur falë një marrëveshjeje me Bashkinë e Elbasanit, e cila ka ofruar hapësirat e saj sportive për përdorim nga studentët.**[Dok.: 4.5: Marrëveshje me Bashkinë e Elbasanit për fushat sportive (AL) 5.18]** Për t'i krijuar hapësirë sportive, universiteti i ofron studentëve që merren me veprimtari sportive, klasa të posaçme konsultimi.**[Dok.: Mbledhjet 4, 6] [Kapitulli I Standardi III.4 & Kapitulli I Standardi III.8]**
- 5.19 Universiteti e organizon praktikën profesionale në përputhje me kuadrin ligjor të ligjit për arsimin e lartë, ku praktika profesionale është pjesë e programit të studimit Bachelor dhe programit të studimit Master. **[Dok. 1.1: Neni. 58- Rregullore e funksionimit, organizimit dhe administrimit të Universitetit të Elbasanit.pdf, Neni. 44]** Në dy fakultete në veçanti, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike dhe Fakultetin e Shkencave të Edukimit, praktikat profesionale janë të organizuara dhe të konsoliduara mirë, si dhe mbështeten në bashkëpunimin reciprok ndërmjet fakultetit dhe institucioneve, ku studentët kryejnë praktikën profesionale.**[Dok.: 3.8: Lista e marrëveshjeve për praktikën profesionale (AL); 4.2: Procedurat për praktikën e studentëve (AL)] - [Mbledhja 7] [Kapitulli I Standardi III. 3&Kapitulli I Standardi III.9]**
- 5.20 Universiteti ka organizuar disa workshop-e dhe panairë pune për t'i prezantuar studentët me tregun e punës.**[Dok: 2.6: Raporti i ditëve të hapura - shembull.pdf ; Mbledhja 5. 7; 3.1 Plani i veprimtarive për Fakultetet e Shkencave të Edukimit për Ditët e Hapura]** Gjatë vitit akademik ofrohen edhe mundësi stazhi, për shembull, mësuesit në formim e kryejnë praktikën mësimore nëpër në shkolla.**[Dok: Mbledhja 4] [Kapitulli I Standardi III.9]**
- 5.21 Universiteti përpiqet të ndjekë një politikë për punësimin e studentëve me rezultate të larta në fakultetet përkatëse. Universiteti ka punësuar disa prej ish-studentëve në detyra me kohë të pjesshme.**[Dok.: Mbledhja 9] [Kapitulli I Standardi III.9]**
- 5.22 Deri më sot, universiteti nuk ka asnjë strukturë institucionale për ruajtjen e të dhënave statistikore për punësimin e të diplomuarve, por të dhëna të tilla zotërohen nga disa departamente.**[Dok.: RVV, fq.52]** Aktualisht, universiteti nuk e ka Qendrën e Alumnit apo një

¹ Këshillat Studentor janë organizime të pavarura të studentëve brenda institucioneve të arsimit të lartë, të cilët nuk marrin pjesë në aktivitetet politike dhe ekonomike. Këto këshille promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të institucionit të arsimit të lartë në strukturat e mësimdhënies, kërkim dhe shërbime (përkufizim ligjor sipas Ligjit për Arsimin e Lartë në Shqipëri, Neni 55).

bazë të dhënash për to. **[Dok.: Mbledhja 9]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e identifikoi këtë gjë si **dobësi** të institucionit, dhe **rekomandon** ngritjen e kësaj strukture sa më shpejt të jetë e mundur. **[Kapitulli I Standardi III.9]**

- 5.23 Universiteti mundi të tregojë një praktikë të mirë në mbështetjen që i ofron studentëve, që është programi i studimit Bachelor në Gjuhë Shqipe dhe Rome. Universiteti ka një program të gjerë dhe të dobishëm për mirëpritjen e studentëve, një sistem EMS të bazës së të dhënave në zhvillim, si dhe staf akademik dhe personel administrativ ndihmës dhe lehtësues. Studentët përfaqësohen në mbledhjet e Senatit, ku axhenda është e hapur për diskutim. Veprimtaritë sportive mbështeten, si dhe organizohen workshop-e dhe panire pune për t'i prezantuar studentët me tregun e punës. Universiteti punëson disa prej ish-studentëve në detyra me kohë të pjesshme. Pikat më pak të forta janë mosfunksionimi i Qendrës së Këshillimit të Karrierës për marrjen e informacionit dhe pranimet, dhe mbështetja në shkallë të gjerë për studentët e rinj. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm sugjeron se kjo strukturë, krahas rolit informues rreth programeve të studimit të ofruara nga universiteti që luan për studentët, të shërbejë edhe si strukturë orientuese. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm sugjeron që universiteti të hartojë dhe miratojë një rregullore institucionale në kuadër të procesit të mentorimit dhe tutorimit për të gjithë studentët. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që drejtuesit e nivelit të lartë të universitetit t'i informojnë studentët për të drejtën e pasjes së një Këshilli Studentor tërësisht funksional, dhe t'i ofrojë mbështetje të përgjithshme dhe financiare. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm sugjeron ngritjen e një Këshilli Studentor në çdo fakultet.
- 5.24 Këshilli Studentor duhet të jetë efikas dhe përfaqësues, si dhe duhet të fuqizohet për të shprehur mendimet dhe për të paraqitur propozime. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi si dobësi mungesën e një sistemi të dhënash, ku përfshihen të dhënat e plota të kontaktit të studentëve. Universiteti nuk ka një bazë të dhënash për alumnit dhe as Qendrën e Alumnit për ruajtjen e të dhënave statistikore për punësimin e të diplomuarve të tij. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm njeq nevojën për pasurimin e vazhdueshëm të bibliotekës, veçanërisht përpjekjet për blerjen e më shumë teksteve mësimore. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi përpjekjet e bibliotekës qendrore për gjetjen e financimeve për dixhitalizimin dhe për mbështetjen e pjesëmarrjen së studentëve nëpër veprimtari kulturore.

Gjetjet

Praktikat e mira

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- hapja e programit të studimit Bachelor për studentët romë në Fakultetin e Shkencave Humane në vitin 2012, i cili lehtëson integrimin e komunitetit rom në arsimin e lartë në Shqipëri (pika 5.10).

Dobësitë

Grupi i vlerësimit identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesa e sistemit të të dhënave për ruajtjen e të dhënave të kontaktit të të gjithë studentëve (pika 5.6)
- mungesa e një Këshilli Studentor tërësisht efikas, përfaqësues dhe të promovuar mirë (pika 5.15)
- mungesa e bazës së të dhënave të alumnit dhe Qendrës së Alumnit për ruajtjen e dhënave statistikore për punësimin e të diplomuarve të universitetit (pika 5.22).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- krijimi dhe ruajtja e një sistemi gjithëpërfshirës të dhënash, me të dhënat e kontaktit të të gjithë studentëve (pika 5.6)
- informimi i studentëve rreth të drejtës për të pasur një Këshill Studentor efikas dhe përfaqësues.
- përmirësimi i të dhënave statistikore për statistikat e vendeve që ofron tregu për profesionet e të diplomuarve të tij dhe të ngritja e një Qendre funksionale për Alumnit (pika 5.22).

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë lidhur me këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur kryesisht.